

## EQREM ÇABEJ

## STUDIME RRETH ETIMOLOGJISË SË GJUHËS SHQIPE XXVIII

**xa** ndf. «qe, ja, na». Këtë fjalë të arbërishtes së Italisë, që s'e gjej-më te G. Meyeri, Kamarda (II 104, 182, 199) e jep me shprehje si *xa besjën* «na besën, qe besa», *xani një dhomatë drū* «eccovi un fascio di legna», dhe e bie të ardhur nga folja *xë, zë*, duke shënuar që shm. *xani* të bën të mendosh që kemi të bëjmë më fort me një folje se me një ndajfolje. Spiegim, nga sa duket, i drejtë. Pra *xa* në thelb «merre», *xani* «merreni»; khs. *na* «merre» dhe «qe, ja». — Do shënuar se *x*, kur nuk çfaqet në huazime prej gjuhësh së tjera, nuk paraqet ndonjë tingull të moçëm në gjuhën shqipe. Ajo ka dalë zakonisht nga africimi i spirantit *z*, ose nga sonorizimi i *c*-së, ose nga asimilimi i grupit *dz*, ose nga metateza e grupit *zd*, dukuri që vihen re dhe në gjuhë të tjera. Ose mënyfund kemi të bëjmë me formime onomatopeike.

**xamare** f.: sh. *zamare*.

**xandë** f.: sh. *xanxë*.

**xanë** f.: sh. *xanxë*.

**xanxë** «huq i keq, cen, ves», e *ka xanxë* «e ka ves, e ka mani». Mun-gon me këtë trajtë të G. Meyeri. Ai (f. 79) jep vetëm, pas Mitkos, *xandë* «cen, e metë», duke e lënë këtë të paspieguar.

Te Tase *xanxë* edhe «plënk zemre, brengë», *vetëm ay ma di xan-xën*. Te Leotti e te Manni *xanxë kuajsh* nuk është dhënë drejt me «çift kuajsh». Me *xanxë* lidhet mbiemri *xanxár*, fem. *xanxare*, si në *mushkë xanxare* «mushkë e pashtuar e që hedh shqelma», edhe për një njeri që s'rri urtë, po nget të tjerët. Afrohet me *xanxë* m'anë tjetër kal. (te Dorsa, Il Vangelo di s. Matteo 4,1) *canxanis* «tundoj, shtyj për në rrugë të keqe, për në mëkat», *i canxanisur ka djalli*, edhe kjo mbetur pa spiegim te G. Meyeri (f. 439). Përjashta shqipes një me *ranxë* është arom. *dzandzã* «caractère, tempérament grincheux; nervosité; fâcherie; emportement». Këtë Papahagiu 431 e krahason me gr. e re ζάντσα «manière particulière; originalité; caprice; bizarrerie», po pa u shprehur më tej për burimin e dy fjalëvet. Në qof-të se me *xanxë*, *xandë*, *xanxár* ka të bëjë edhe emri i gjeshtres në disa dialekte të toskërishtes, *xanë*, bimë me degë të holla e majuke, thelbi kuptimor i këtyre fjalëve është ai i majës a thumbit.

**xarbë** f.: sh.: *carbë*.

**xehë** f. «minierë, gropë e gërmuar pingul në dhe, nga ku nxjerrin minerale», te Rossi *cehë sehë; xehetar* m. «minator», mb. *xeherór* «që u përket xeheve, mineral», neologjizma mbetur jashtë përdorimit. Prej skr. *ceh* «esnaf, korporatë», e kjo prej gjerm. *Zeche* «minierë; korporatë minatorësh», G. Meyer 440.

Fjalë e geg. veriore, e përgjithësuar në gjuhë, me gjithë se nuk ka zënë dot vendin e *minierë-s*. Del që te Bogdani (I 36, 15): *tue kjanë dheu plot ceha* (ose *xeha*), *Ari, Rëgjandi, e shumë duer s'jetër gjanje* «essendo il Paese pieno di miniere di diversi metalli». Për bazat historike të depërtimit të fjalëve gjermane të minatorisë në gjuhët ballkanike sh. E. Preissig, *Deutsche Bergmannswörter in den Balkansprachen nach einem Zeugnis der französischen Renaissance*, Germanoslavica 3 (1935) 142 vv. Për përdorimin e fjalës në serbokroatishten M. Pavlović, *Cerc. de Lingv. III 1958 (Mélanges Petrovici) 376*. Për fjalët e gjermanishtes që kanë hyrë në shqipen nëpërmjet të serbokroatishtes Jokl *Balkangerm. u. German. im Alb. 123 vv. Sh. dhe më lart te mashterk*, ku jepen edhe shembëj të tjerë.

**xëgít** «ngas, shpoj, ngacmoj», *xëgój* «xëgít», *xëgím* m. «të xëgíturit, ngacmim». Mungon te G. Meyeri. e kanë fjalorët botuar pas tij. Edhe te N. Frashëri (Iliadha e Omirit v. 953), *me heje xëgítin zjarrë*. Në të folët e Dangllisë *zugulit qetë me hosten* (Sp. Floqi BUST SSS XII Nr. 3 f. 150), me një kryqëzim me *dugulis gudulis* «xigloj». Është një trajtë metateze e *gëcít* «tundoj» *guxít guzít* «ngas, gërgas», ku hyjnë edhe *gacít, gëzhít, gëzhás* «gërgas», *gaxhís, gaxhít* «bëj shaka» etj., të gjitha të afra me *cys* e *nxit*.

**xullufe, cullufe** fsh. «flokët e prera shkurt, që u varen gravet nga tëmblat», edhe «thekët e kallinjvet të grurit». Prej turq. *zülüf* (kjo prej persishtes), e cila ka shkuar në gjithë gjuhët e Europës juglindore, Miklosich TEN II 189, G. Meyer 442, Lokotsch 2230, Mladenov 195, Andriotis 269, DLRM 960, Papahagi 1066. Fjala e shqipes është një shumë, i përdorur ndonjëherë edhe si njëjës.

**xunkth, zunkth** m. «*Iuncus inflexus*». Këtë emër bime G. Meyeri 489 e bashkon me trajtat *xhünkël'ë* «cespo» (De Rada) e *zhukë zhugë*, dhe spiegon me të drejtë të parën prej it. *giunco* ven. *zunco*, të dytën prej asaj me anë të skr. *žuka* «*Spartium iunceaum*» *žuk* «*Iuncus*». Pa të drejtë ai vendon aty edhe *sung* «*vitis*, hardhi» të Bardhit, të cilën e ka dhe Budi SC 133, 287. Kjo, s'është gjë tjetër veçse *cung hardhie* «hardhi», duke mbetur jashtë *hardhi-a* me anë të një elipse, sh. dhe *cung*. M'anë tjetër Weigandi 16 *xung-un* jo me të drejtë e bie të ardhur prej lat. *iuncus* it. *giunco*. Tingulli nistor i fjalës tregon se është një huazim venecian, nga *zunco*. Trajta *xhünkël'ë* e De Radës vjen prej it. *giunco*. Sufiksi *-th* te *xunkth zunkth* e ka bjerrë kuptimin e zvogëlimit, ashtu si në rasat që jepen te Xhuvani-Çabej, Prapashtesat 95. Sh. edhe *zhukë*.

**xhagajdúr** m. «kopuk që kapardiset, njeri që kërkon sherr; njeri i gjallë fort, zevzek, njeri që s'lë dy gurë bashkë», fem. *xhagajdure*. Këtë fjalë të anës së Shkodrës G. Meyeri 136 e jep pas Rossit me format *xhakahiduer xhagaidure* e me kuptimin «*mascalzone*» dhe e spiegon si *gjakhidhuer*, nga *gjak-u* dhe *hedh hidhem*, pra si «gjakderdhës».

Spiegim i padrejtë. Një *hidhuer*, nga *hedh hidhem*, nuk del gjë-kundi; dhe *hedh gjak* për «derdh gjak» nuk përdoret në shqipen. Nga fjalorët e Veriut, Junku ka *gjaqaidūr*, *-dori* «birebante, furfante», Bashkimi *gjaqaidūr* «furfante», Ali Ulqinaku *xhagajdūr* = turq. *haylaz* «indolentë»; Godini e ka për gjerm. *Gauner, Lump, Schelm, Schuft*. Në të folët e Elbasanit *xhagadūr* «kapadai» (M. Domi). Në Shkodër ndërkaq ndihej dhe *xhakatūr* «ai që mbledh kumarxhinjtë në shtëpi të tij, u jep të hanë e të pinë e i ruan nga policia». Nga it. *giocatore* «lojtar; kumarxhi». — Edhe nga fjalët që nisin me *xh-* shumica janë burimi të huaj. Nganjëherë (në Veri) kemi të bëjmë me një *gj-*.

**xham** f.: sh. *gjëmë gjamë*.

**xhanfés** m. «pëlhurë e ndritur prej mëndafshi, tafta». Mungon te G. Meyeri, e ka FGS. Prej turq. *canfes* «tafta». Kjo ka shkuar edhe në të tjera gjuhë ballkanike, Miklosich TEN I 32, Skok Slavia XV 342, Andriotis 254, Papahagi 532.

**xhavidhe** f. «gocë deti». G. Meyeri 80 e jep (pas De Radës) për ar-bërishten e Kalabrisë dhe nuk e spiegon nga ana e burimit.

Paraqitet me variante të ndryshme edhe në ligjërimet e toskërishtes. Si *xhavidhe*, ashtu si në Itali, edhe në çamërishten e në anët e Bregdetit. Në Vlorë *xhixhivadhe* «një lloj gocë deti e vogël»; në Seman *shivadhe* «guaskat e vogla që nxjerr deti në breg» (J. Thomaj BUST SSS XV Nr. 4 f. 152); në Myzeqe (Spolata e Lushnjës) *sharavidhe* (Gjinari poaty XII Nr. 4 f. 103); te Godini 261 *shivallë, zhilvadhë, zhavidhe, sharravidhe*, të Manni edhe *xhaville*, pranë *laravidhe* «dyzetkëmbëshe»; edhe *shkaravidhe* (Xhuvani-Çabej BSS 1956, Nr. 4 f. 98). Në bregdetet jugore dhe *hivadhe*. Shformime të ndryshme të gr. së re popullore *χηβάδα χημάδα* në shkrim *ἀχηβάδα* «një lloj goce deti», prej gr. së vj. *χημη*. Për fjalën greke, përhapjen e trajtat e saj dialektore. sh. Rohlfsin BALM II 16, LG 554 v. Në shqipen zhvillimi ka shkuar nga *hivadhe* në *shivadhe shivallë* e *shilvadhë* etj., me zëvendësim të *χ-*së greke me *sh* e të kësaj me *zh*. Me metatezë e me ndikim të prefiksevet *shara- shkara-* (Xhuvani-Çabej në vendin e cituar) *sharavidhe shkaravidhe*. Nën ndikim të *larë-s laravidhe*. Në këto trajta metateze hyn dhe *xhavidhe* e Kalabrisë, Çamërisë e Bregut të Detit. Giordano jep për Frasnit edhe *xhavidhe ari* «conchiglia d'oro».

**xhevahir** m. «diamant; brilant»; mb. *i xhevahirtë*. Prej turq. (në thelb arab). *cevahir* (shumësi i *cevher* «gur i çmuar»), e cila ka shkuar me të dyja trajtat edhe në të tjera gjuhë ballkanike, Miklosich TEN I 33, G. Meyer 81, Weigand 16, Mladenov 126, Papahagi 539. Sh. edhe vrejttjet tona LP VIII 74, ShS 84. Nga *cevher, cevherdar* rrjedh dhe *xheverdare* f. «një lloj pushke me gur», një fjalë që e ka dhe serbokroatishtja.

**xheverdare** f.: *xhevahir*.

**xhikë** f. «titull që u jepej zonjave muhamedane në Toskëri». Ka mbetur e paspieguar te G. Meyeri 81.

Në Gjirokastrë me *xhiko*, që është *xhikë* me *-o-* në vokative, nusja i drejtohet motrës së burrit e përgjithësisht çdo kunate më të madhe; me *katënxhikë* i drejtohet së vjehrës. Kjo është turq. *kadincik* «amvise e mirë», në thelb «grua e vogël», morfologjikisht *kadin-cik*. Prej kësaj u shkëput *-cik* e doli më vete si *xhikë, xhikë*.

**xhudhi** m. «çifut». Pas G. Meyerit 82 vjen nga it. *giudeo*; poashtu pas Helbigut 33, i cili ndërkaq mendon se fjala ka shndruar sufiks në gjuhën shqipe. Lambertzi (Alb. Märchen 26 v.) spiegon dhe trajtën *xhulli* (me ndrimin e ditur *dh*: 11) dhe mendon se figura e besimit popullor që mban këtë emër do të jetë e kohëve të lashta në Shqipëri. Khs. dhe E. Reimerin IJ VIII VII 47 (N. Jokl).

Del që te Buzuku, p.sh. (XXXVIII, Gjoni 2, 6; XL, Korintasit II 11, 22) *porsi ish të purifikuomitë e Xhudhivet* «secundum purificationem Iudaeorum»; *Ata në janë Xhudhi, edhe u jam* «Hebraei sunt? et ego»; Budi (RR 40, SC 189, 386) *gratë e gjudhivet, o të t pëganëvet; qi as n'aj xhudhu, o t pëgani s i përket t atiatë kafshë me j bām, e me j sandërgjuom; mase ndonjë xhudhi o të pëganë po larg atje ke as vorri të mos i dihetë*; Bardhi Iudaeus, Giudeo *Xhudhi*. Për *Vorret e Xhudhijve, Vorret e Xhullijve*, përveç Lambertzit khs. edhe E. Reimerin (IJ VIII VII 47) dhe HD VII 537, 544 (Lesteri, Selita e Keqe, Mali i Bardhë në anët e Kurbinut), për *Guri i Xhudhijvet* në Kryezi sh. *Excurrens* te Leka VI 57. — Figura e xhudhive ka diçka të gjashme me atë të paganëve; kjo i detyrohej ndikimit të kishës, në të cilën paraqiten si të dënueshme dhe njera lagje dhe tjetra, si kundërshtarë të krishterimit; ashtu spiegotet dhe paraqitja e të dy emrave të bashkuar të Budi. Trajta e emrit, me *-i*, nuk spiegotet nga shumësi *xhudhitë*, si mendonim më parë (LP VIII 73 v., ShS 83 v.). Fjala rrjedh prej it. së vj. *giudio*, sh. tani ShS 167; pra kemi të bëjmë me një huazim italian mjaft të mëdhem. Lidhur me trajtën me *-ll-* të emrit, *xhulli*, do shënuar se labializimi i *dh*-së në *ll*, i cili është mjaft i vjetër në disa dialekte të shqipes (sh. Z. f. Balk. II 22, Rev. Shk. e Inst. Pedag. Dvjeçar Shkodër I 19), mbi dëshminë e saj, në anët e Verriut duhet të ketë vazhduar gjer vonë. Prandaj gjejmë *xhudhi* tek autorët e vjetër të asaj ane, sot në gojë të popullit më fort *xhulli*. — Për *zhid*-in e gjuhëve sllave Vasmer REW I 423. Për *jidov* «kiklop, vigan» të rumanishtes Tagliavini, Divagazioni semantiche rumene e balcaniche, sh. IJ XXII VII 239. — Sh. edhe *jud*.

**xhulli** f. «një si gunë e bariut, veshje për përsipër, pa mëngë, e leshtë e e zezë, me gajtanë të kuq, e e gjatë mbi gju». Fjalë e gegërishtes, mungon te G. Meyerit. Te Weigandi 16 *xhullin*-a, si sinonim i jakuces. Mëqë një variante e saj, *xhëlli*-a, te FGS do të thotë «xhurdi» të *xhulli* e *xhëlli* pas gjase kemi të bëjmë me trajta të *xhurdi*-së. Ndrim i *d*-së në *dh* pas *r*-së e më tej në *l* (khs. më lart *xhudhi xhulli*); rënie e likuidës *r*, nazalizim sekundar i *i*-së fundore.

**xhurá** f. «fyell i bariut», përdorur sidomos prej N. Frashërit. Me të drejtë bashkuar prej G. Meyerit 487 me *zurnë* e *zurná* «vegël muzikore me frymë e përbërë prej një tyte, surle», nga turq. *zurna*. Trajta të tilla si *xurë* «fyell i bariut» te Godini (s. v. Schalmey), me *x*-në e tyre sqarojnë fonetikisht kalimin *z*: *xh* te *zurná*: *xhurá*. *r*-ja e kësaj me asimilim të grupit *rn*. — Sh. edhe *zulmë*.

**xhurdhék** m. «martesë», vetëm te F. Santori prej Kalabrie. Pa spiegon etimologjik te G. Meyerit 82.

Fjalë popullore e arbërishtes së Kalabrisë, ose fjalë librash, marrë prej këtij autori nga shkrimet e Shqipërisë; *t'ënjten parna të diellën e xhurdhekut* «al giovedì antecedente la domenica del coniugio», cituar te Giordano. Një me *gjerdek gjerdek* «shtrati i martesës», prej turq. *gerdek* «camera nuziale», regjistruar te G. Meyerit 139.

*ýjzë* f. «kyç, nyell në një pjesë të trupit». Këtë fjalë që jep Hahni (më vonë dhe Kristoforidhi) për gegërishten, G. Meyeri 460 e bashkon etimologjikisht me *yll hyll*. Bariçi (Arhiv I 158 v.), duke u nisur nga një bazë \**ūlnā*, mendon për këtë një zhvillim fonetik \**ylē* e *yjē*, dhe e afron fjalën me gr. ὀλένη «*bërryl*». Spiegimi i drejtë gjindet te Jokli (IJ X VII 67): *ýjzë* variante e *nýjzë*-s, kjo nga lat. *nodus*.

Primitivi *nyjë* me kuptimin e kyçit (të dorës, të këmbës) trajtohet te G. Meyeri 302, e ka dhe Weigandi 63. Te *nyjëzë* që u bë *yjzë* na paraqitet një zbrëthim që si proces morfologjik është e përkundërta e përngjitjeve të tipit *nëndërr* për *ëndërr*, *nije* për *ije*, për të cilat sh. Xhuvani-Çabej BSS 1956 Nr. 4 f. 82 vv. Të dyja proceset kanë ndodhur në ngërthim të fjalisë: *nëndërr* p.sh. në fjali si *e pa në ëndërr*, *nije* nga *më dhemb n ije*, sh. *ëndër*, *ije*. Përkundrazi *nyjëzë* u muar sikur t'ishte *n yjzë*, e kështu u bë zbrëthimi që dha formën e re.

*ylbër* m. G. Meyeri (f. 460 v.; IF 6, 114 v.) shënon emërtimet e ndryshme të kësaj dukurie qiellore në shqipen e në gjuhë të tjera, sidomos të Gadishullit ballkanik, po nuk jep ndonjë spiegim etimologjik të fjalës. Weigandi 102 e merr si «gjarpër yjsh», nga se del që ai e zbrëthen në *yl e ber* «lloj gjarpëri», duke pranuar aty dhe një ndikim të etimologjisë popullore. Furikis (Ἡμερολόγιον τῆς Μεγάλης Ἑλλάδος 1935 f. 343 v.) jep emërtimet dialektore (Elbasani *ylbër*, Berati *ylëbër lylybër*, Paramithia e Çamërisë *ylibër*, Himara *kulubër kultuvër*, Shkodra *voj e ufull*, çamërishtja edhe *brezi i Perëndisë*, shqipja e Atikës dhe brezi i Sër Mërisë, *brezi i kalogresë*, *kamare*, *kamáreza*, *kamárea* e *qialit* «ku-beja e qiellit» etj.), dhe gjen aty një kompozit *yl* «yll» e *ber* me kuptimin e shigjetës e të heshtës.

E mbarë gjuhës. Bardhi Iris, arco celeste *Dylbër*, duke u përzier fjala me *dylbër*. Traja e përgjithshme është *ylber*. Atje ku në vend të *b*-së ka *v* (Mallakastra në ndonjë ligjërim *ylvër*, Piqerasi i Bregdetit *livër*, Hundëcova *vajzovër*, Gjinari BUST SSS XVI Nr. 3 f. 176, Totoni SF XVIII=I Nr. 2 f. 131, Vunoi i Bregdetit *kuluvër* et.), ka ndërhyrë *vera*, sepse ylberit nga puna e ngjyrave të ndryshme të tij i thonë vise-vise dhe *vaj e verë* e *uthull* (çam. *uthull e val*, Shkodra, si u pa, *voj e ufull*). Për hetimin e historisë e të burimit të fjalës do pasur parasysh se, si në shumë gjuhë të tjera (G. Meyer në vendin e cituar, Schwyzer WuS XII 32 v.), edhe në shqipen ylberin e lidhin me idenë e një brezi a harku, lidhje që thuret edhe me besime popullore të ndryshme, sh. për shqipen sidomos E. Reimerin IJ VIII VII 47. Khs. nga kjo anë *brezi i zonjës*, *shoka e zojës*, nga *Acquaformosa* e *Kalabrisë brezi pjakavet* (Rohlf's AIS II 371), formim analog me gr. e re *tsi grás to lurí* «brezi i plakës, ylber», që sipas Rohlf'sit LG 188 përdoret në Kretë. Në këto rrethana edhe te *ylber* do hetuar ndikimi i besimit popullor, do shikuar fjalëformimi në lidhje me të dhënat e etnografisë. Edhe kjo fjalë përmban një emërtim të këtij lloji. *ylbër* është *yl-ber*: *yl* «yll», *ber* «hark», në *me shigjet' e ber*, *beri i harkut* «lakesa e harkut», *beri i urës* «harku i urës» (Berat), sh. *bër*. Morfologjikisht *ylbër* është një kompozit determinativ me kuptim ndajshmtimor (atributiv), pra me kuptimin «yll-hark, yll që është hark». Sh. për këto lloj kompozitash në gjuhët indoeuropiane Brugmannin II/1 49. Neologjizmat e këtij lloji në shqipen (*kryeqytet*, *mëmëdhe* etj.), që trajton Jokli (Naim Frashërit 93) janë formuar kundra fjalëformimit të shqipes, pas gjedheve të huaja. — *Te vaj-*

*zovër* ka një shformim të *vaj* e *verë* nën ndikim të etimologjisë popullore, duke ndërhyrë fjala *vajzë* me atë kuptim të një hyjnie femërore si dhe te *brezë* i *zonjës* etj.

**yndyrë**, *undyrë* f. «lyra që lëshon mishi i majmë kur zien», i *yndyrshëm* «i lyrshëm». Nga lat. *unctūra*, Miklosich AF II 69, G. Meyer 461, Meyer-Lübke Gr Gr I<sup>2</sup> 1047, Puççariu EW 1820, Weigand 102, khs. dhe Barićin Arhiv I 145.

Mosrënia e zanores nistore të pathekse dëshmon për këtë fjalë një huazim nga një periudë më e vonë e latinishtes, poashtu si dhe për *iriq*, *uroj* e ndonjë tjetër.

**zagâl** m. «zekthi që i ngjitet gjedhit». E paspieguar te G. Meyeri 480, i cili e jep — sipas Hahnit — gabim me formën *zagall*. Kristoforidhi *zagâl* e *zegâl*, e për Berat *zegól*. Në Vlorë *zegâl*, në Gjirokastër *zágâl*. Këto forma dëftojnë që fjala është një me *zekth*. Sonorizim i guturalit, zgjerim me sufiks *-al*, asimilim regresiv i *e-së* në *a*, nën ndikim të *a-së* së rrokjes fundore. Për *-al* Xhuvani-Çabej Prapashtesat 12.

**zagár** m. «qen gjahu», edhe emër familjeje, fem. *zagare*; figurshëm «njeri rrugaç, rrugaç i keq». Fjalë me burim të diskutuar, e përhapur në shumicën e gjuhëvet ballkanike. Ndërsa Diefenbachu (I 258, II 380) e spjegonte nga avar. *egér*, që prej Miklosichit (TEN II 186) e këtej nga shumë anë mendohet për një burim prej turq. *zagar* «qen gjahu»; sh. G. Meyerin 480, Weigandin 102, Höegun II 121. Triandaphyllidis 145 me Andriotin 69 gr. e re ζαγάρι e nxjerrin nga gr. e mesme ζαγάριον dhe këtë vetë prej arab. *sakar*. Mendimin e Miklosichit (Slav. El im Türk. 24) që fjala e turqishtes të ketë dalë prej sllavishtes (*ogarbъ* «zagar»), disa nga pasardhësit e tij e kanë zgjeruar në këtë vështrim, që edhe fjala e gjuhëvet ballkanike ka rrjedhur prej atij burimi sllav, Mladenov 171, Skok Jugosl. Encikl. I 162, sh. edhe M. Pavlovićin, Matica Srpska, Zbornik filol. i lingvistiku II (1959) 28. Kundra spjegimit të fjalës me mjete «alarodike» nga ana e Oštirit (Razprave Izdaja Znantsv. Društvo za human. vede v Ljubljani I 305) Jokli (IJ XI VII 181) vren me të drejtë që *g-ja* ndërzanore e *zagar*-it dëshmon kundra një lashtësie shumë të madhe të fjalës në gjuhën shqipe. Sipas M.L. Wagnerit (Arch. Rom. XV 207 vv., sh. IJ XVII VII 227) *zagar* lidhet, si një fjalë e lashtë para-indoeuropiane, me sard. (logodur.) *giägara* «zagar», dhe si e tillë bën pjesë në një grup përkimesh leksikore midis shqipes e sardishtes. Afërsisht ashtu më vonë edhe Hubschmidi (Mediterrane Substrate 20), i cili *zagar*-in e gjuhëvet ballkanike, si një fjalë para-indoeuropiane-mesdhetare, e afron me bask. *zakeir* «qen», sard. *džagurn* «zagar», kors. *ghvágaru* «qen» *jácaru* «qen stani», gjeorgj. *džayli* «qen», khs. edhe Alession St. Etruschi XXIX 368v., Popovićin 614v. Kundra mendimit të Korshit, që sll. *ogarbъ* «zagar» bashkë me gr. e mesme ζαγάριον të kenë dalë prej çerk. *hager* «zagar», Vasmeri REW II 251 vë re që ndikime çerkese në sllavishten e në greq. e mesme nuk dihet të ketë. Nga gjuhët kaukazike (gjeorgj. *jogori* «qen») drejtohet në këtë mes dhe Treimeri Ethnogenese d. Slawen 44.

Fjalë e mbarë gjuhës. Bardhi Vertagus *Zagār*. Për arsyen fonetike të ruajtjes së *g-së* ndërzanore, si u vu re dhe më sipër, nuk mund të jetë fort e moçme në shqipen. Mungesa e saj në arbërishten e Italisë flet më fort për një burim prej turqishtes se për një huazim bizantin

të kohës paraturke, me gjithë se terminologjia e gjahut e gjuhës shqipe i detyron bizantinishtes disa fjalë. Puna e burimit të fjalës bizantine e turke përbën një tjetër çështje. Mbase ajo ka lidhje afërie me botën mesdhetare, me sardishten e baskishten më njerën, me gjuhët kaukazike më tjetrën anë.

**zakúm** m. «Nerium oleander, landër, marshallojë». Mungon te G. Meyeri, me gjithë se e ka Mitkoja f. 400. Mitrushí 401 e jep për të folët e Beratit. Huazim krahinor prej turq. *zakkum*. Fjala turke nuk ka depërtuar në gjuhët ballkanike.

**zall** m. «gurmacë bashkë me rërë, që sjell lumi me vete e i shtron në shtrat të tij; anë lumi që shtrihet me zall e që shumë herë mbetet më të thatë; anë lumi, anë deti». G. Meyeri më parë (AS I 65) e vendonte ndër fjalët vetiake të shqipes; më vonë (Fj. et. 480) e bie të ardhur prej lat. *sabulum*, *sablum* «kum, rërë», me një sonorizim të spirantit nistor, ashtu si në *zhur* pranë *shur* prej lat. *saburra*. Poashtu Weigandi 103. Fjala sllave sll. e vj. kishtarë *žal* «ripa» skr. *žal* e *žalo* «zall, breg lumi a deti», sipas mendimit më të përgjithshëm (Miklosich Lex. palaeosl. 191, G. Meyer 480, Schütz Die geogr. Terminol. d. Serbokroat. 82 e të tjerë) buron prej gjuhës shqipe. Bariçi (I 118v, Arhiv I 100, Hýmje 52) gjen te *zall* një fjalë vendi të shqipes, refleksi i një indoeur. \**gás-l-* dhe e afër me irl. *gall* «brokë guri, gur, kazan», gjerm. e lartë të vj. *kis kisil* «zall, zhavorr» e lit. *žiezdrà* «zhavorr»; forma e qëmoçme e *zall-it* sipas tij një \**xhall* me afrikatë, prej nga rrjedh sll. *žal žalo*. Një fjalë të burimit paraindoeuropean, «alarodik», të afër me emrin e hyjneshës greke Ἀθήνη, sheh te *zall* Oštiri (Alarodica I 278), sh. IJ XI VII 181. La Piana (SLA I 70, SLA Varia 33) e lidh këtë fjalë, si një element indoeuropean të shqipes, ashtu si më parë edhe Kamarda (I 93), me gr. *αγιαλός* «breg deti», duke e çuar *zall-in* te një formë bazë \**ezaló* \**ezálu* e duke parë te *z-ja* e tij refleksin shqiptar të një *g-je* palatale indoeuropiane. Ndryshe nga ai, Popovići 614 te skr. *žal* e shq. *zall* gjen një fjalë indoeuropiane të lashtë, «pellazgjike», e afër edhe pas tij me gr. *αγιαλός*. Për Skokun (Jugosl. Encikl. I 162) *zall* është e burimit sllav.

E mbarë gjuhës. Del sëpari më 1343 te toponimi *Zale* pranë Krujës, e më 1397 si *zali de Matcho* «zalli i Matit», Acta Albaniae I 834, Šufflay Arhiv II 214, 212. Buzuku (LXI=LXXI, Gjenezja 22, 17; LXXXVI/2 = =CVI/2, Urta 7,9) e tue të shumuom u të shumonj farënë tande porsí uillitë e qiellët e porsí zallí qi anshhtë pranë detit «et multiplicabo semen tuum sicut stellas caeli, et velut arenam quae est in littore maris»; përse gjithë ari e rgjandi për të njëmendunë anshhtë gjithë zall e pështymë «quoniam omne aurum in comparatione illius arena est exigua, et tamquam lutum extimatur argentum in conspectu illius». Bardhi Litus *Zall*, Litus maris *Zalli i detit*. Bogdani (II 137,22) ndaj *zallt* «appresso la riva». Rrjedhoja janë *zallishtë* e *zallinë*, për kuptimet e të cilave sh. FGS; në Kastrat *zallin-a* «tokë joprodhuese me shumë zall» (Shkurtaj SF XXI = IV Nr. 3 f. 57). Geg. veriore edhe *zallí* f., në vargun *Qi ushtoi vigma ashtu zallís*. Në Mat edhe *zallúr* «njeri që banon në zall, në luginën e një lumi», K. Ulqini BUST SSS XV Nr. 3 f.216. Shumësi *zalle* e *zaje* (kjo te N. Frashëri), te De Rada (Fiam. Arbërit II Nr. 1 f. III, Nr. 5 f. I) *íkku zaljeve të larguar* «fuggi in lidi remoti», *lkā zaljet* «dalle spiagge»; në *Zaje* edhe toponim në Pland (A. Sirdani Neka XV 223). — Nga etimologjitë e parashtruara gjer tani, spjegimi i fjalës prej lat. *sabulum*,

si është vënë re dhe nga të tjerë, bie për arsye fonetike, një *s* latine para zanoreve ka dhënë në shqipen gjithmonë *sh*. Bie edhe mendimi i një burimi sllav, sepse fjala nuk gjen spjegim brenda sllavishtes. Afrimi me irl. *gall* gjerm. e lartë të vj. *kisil* dhe ai me gr. *αἰγιαλός* mbështeten të dyja në rregullën e një reflektimi të palatalit të zëshëm indoeuropian me *z* në shqipen, rregull që sot nuk mund më të qëndrojë. Mendimi i një burimi pellazg është pa mbështetje. Hetimi i burimit të fjalës vështirësohet nga puna se nuk dihet kuptimi i parë i saj, sh. vrejtjet tona BSS 1952 Nr. 3 f. 56 v., Z. f. Phon. u. allg. Sprachwiss. 9, 226v. Në qoftë se ai ka qenë «breg, anë lumi a deti», ajo mund të jetë e afër me fjalën kelte kymr. *ialos* «espace découvert, clairière» (në emra vendesh), *ial* «fushë», të cilën e kanë krahasuar me sll. *jalъ* «djerr, qersë» let. *jêls* «i papjekur». Po në qoftë se kemi të bëjmë në thelb me një kuptim «guralek, kokrrizë», mund të mendohet për një afrim me gr. *ἄλιον-ἐρέβινδον* ἢ τὴν δάλασσαν (Heziku), pra «qiqër» e «det». Të dyja etimologjitë mbështeten në mendimin tonë që *z*-ja e shqipes në disa fjalë ka dalë prej një *i*-je (*j*-je) indoeuropiane. Gjithsesi gurra e fjalës mbetet e errët.

**zallnisem** «sillem poshtë e lart. endem». Këtë fjalë që jep Hahni për gegërishten, G. Meyeri 480 e nxjerr prej serbokr. *zaludan* «i kotë, i tepër». Selishçevi nuk e numëron ndër huazimet sllave të shqipes. Më parë Kamarda (II 68) e lidhte me *dallandis* «tallandis, tund».

Vjen nga turq. *salinmak* «me u përkundë», perfekti *salindi*. Kështu fjala është një me *sallanditem* «përkundem, shilarëm në shrrëgull», që trajtohet te G. Meyeri 378. Prej turq. vjen dhe *sallxhak* *sallënxhak* m. «shrrëgull, shilarës».

**zamare** f. «pipëz e bariut, fyell i bariut». G. Meyeri (f. 79, AS V 106) e jep pas Hahnit si *xamare*, pas Rossit si *zamár* f., për shqipen e Greqisë si *zamarë* e me kuptimin «fyell dyjar, fyell arixhish», dhe mendon — me rezervë — si burim it. *ciaramella* «zamare».

Fjalë mjaft e përhapur nëpër dialekte: tosk. jugore (në Gjirokastër) me fortim të spirantit nistor *xamare*; geg. veriore (Shkodra) *zumare*, te Junku «piva, zampogna», atje edhe — me ndikim të *zani*-t — *zama-mare*, te Junku *zunamare*; me zhvillim të një *b*-je si tingull homorganik pas *m*-së zambare, kjo edhe te Sp. Dine e te Lambertzi. Te Hora e t'Arbëreshvet (Piana) në Siqeli *zumare*, në poezitë e Skiròit edhe *zumárezë*. Përshkrimi e përdorimi i veglës në viset e ndryshme të Shqipërisë te R. Sokoli BSS 1954 Nr.4 f.125 vv. Përjashta shqipes çfaqet dhe në aromunishten e si fjalë baritore sporadikisht dhe në greq. e re: *τζαμάρα* «μακρὰ arom. *dzamárá* «long chalumeau des bergers», gr. e re *λογέρα βραγνή*. Papahagi 430, i cili e lë pa spjegim etimologjik. Rrjedh në analizë të fundit prej arab. *zammāra* «fyell kallami, «zamare». Fjala arabe ka shkuar dhe në dialektet greke të Kalabrisë, si *zambāra dzambāra dzammāra tsommāra* etj., sh. për këto Rohlfsin EW 726. Ndërsa në Itali jugore fjala arabe do të ketë hyrë drejtpërdrejt, në gjuhët ballkanike duket të ketë depërtuar nëpërmes të turqishtes ose të greqishtes bizantine.

**zanë** f. «figurë e besimeve popullore shqiptare, e përfytyruar si një vashë e bukur e luftarake, ndihmëtare e trimave dhe e drangojve, po që besohej se edhe të shkal, të shiton», *shitoftë zana, trim si zana*. Mun-

gon te G. Meyeri, me gjithë se e jepte më parë edhe Hahni (Reise Drin-Wardar 69), duke folur për zanat si një shumësi. Junku ka *zā zana*, shm. *zana* «musa, sibilla», Bashkimi *zanë* «musa, diva». Jokli më parë (Studien 97v.), duke u nisur nga cilësitë e zanës si një hyjni e këngës, e bashkonte emrin e saj me *zā zani*, *zë zëri*, dhe për arsye fonetike (asibilim *dj*: *z*, po m'anë tjetër ruajtje e *dj*-së në *djall* nga lat. *diabolus*) e largonte idenë e një burimi të fjalës nga lat. *Diana*, emri i hyjneshës romake të hënës e të gjahut. Më vonë (IJ XI VII 158 e 190, X VII 136, XII VII 83), duke u bashkuar me një mendim të Meyer-Lübkes, për disa arsye gjuhësore dhe etnografike (*zanoi* «shkal, shitoj, shuplak»: sard. *yana* toskan. e vj. *jana* «shtrigë», fuqia e zanës në dhitë e egra të saj: *Diana* me dhitë), me të drejtë kthehet te mendimi i një burimi nga *Diana*. Mendim i pranuar nga shumë anë: Lambert Alb. Märchen 40 shën. 2, Barië Arhiv II 400 (kundra Pascut). Densusianu GrS II 312, Weigand BA I 264, Walde-Hofmann I 347.

Fjalë e mbarë gjuhës: Përveç gegërishtes e ka dhe toskërishtja, në Labëri e në Breg të Detit *zërë* «vashë shumë e bukur», Real Illyria I Nr.52 f.3, vrejttjet tona HD XV 163, XVIII 5vv., 144 vv., 227 vv., Leipz. Vierteljahrsschr. f. Südosteuropa 4 Nr. 1/2 84, 5 Nr.3/4 229 vv.; shto tani dhe emrin e familjes *Zëra* në Labovë të Kryqit (Libohovë). Në shkrimet e Veriut çfaqet për herë të parë të Bogdani (I 162), e *bukura ma fort se zanë*. — Si e kemi shënuar në ato vise, kulti i fortë i Dianës në Gadishullin ballkanik të kohës antike, kult që dëshmohet me mbi-shkrimet e me stacionet e shuma me emrin *ad Dianam* (sh. edhe Patsch, Klio 31, 442v.), dëshmon për ekzistencën e një hyjneshe vendëse të gjashme me Dianën romake dhe tregon që *Diana* aty nuk është veçse «interpretatio latina» e një hyjnie të tillë. Në këtë mes është me rëndësi kjo, që në anët e Kroacisë e të Bosnjes na dalin mbishkrime me emrin e një hyjnie ilire shkruar me formën *Thana* (*Vidaso et Thanae, Vidasus. Aur. Thana patrono* etj.), i cili piqet më një anë me lat. *Diana*, më një anë me shq. *zana*, A. Mayer I 336, II 116v., 205. Te grafia *th* pas mendimit tonë përmbahet aty një tingull i veçantë i ilirishtes, i papërcatueshëm më saktë, i cili mund të ketë një lidhje me tingullin që ka qenë para *z*-së së *zanë*-s të gjuhës shqipe. Edhe M. Pavlović (Z. f. Balk. I 73 v.) ka vënë re se *Diana* — *zana* ka lënë reflekse edhe në serbokroatishten, te figura e *majka Jana*-s. Në këto rrethana mund të mendohet që vila e poezisë popullore të sllavëve të jugut, e cila si një vashë luftarake e mburojë e trimave ka tipare të ngjashme me zanën shqip-tare, si emër të jetë sllave, si qenie të ketë marrë shumë prej substratit parasllav të Ballkanit perëndimor. Me anë tjetër lat. *Diana* ruhet edhe si emër në *zina*-n e rumunëve. Khs. tani dhe vrejttjet tona në Studien z.Sprachwissenschaft u.Kulturkunde (Gedenkschr, f.W.Brandenstein) 285v.

**zavrát** m. «postat, lehe». Këtë fjalë që s'e ka G. Meyeri, e jep Kristoforidhi për «postat». Tase ka *zavrat*, shm. *zavretë* «kthenjë are; brazdë e gjatë 40-50 çapa», me shënimin «fjalë e huaj». Si fjalë e toskërishtes vjen nga bullg. *zavratъ* «kthesë», *zavratja* «me ktheje». Kuptimi i parë është «kthesë». Nga kjo anë i përgjigjet nga fusha e shqipes fjala *kthenjë* «vendi ku kthehet parmenda në të lëruar tokën» te Tase, i cili jep dhe spjegimin «përdoret sidomos për ara tepër të gjata, ku qetë nuk mundin të heqin brazda shumë të gjata. Këso farë arash i ndajnë në ngastra që lërohen veç e veç; edhe këtyre ngastrave u thonë kthenja».

**zbaticë** f.: sh. *baticë*.

**zbató** «shtie në veprim, kryej» (p.sh. një mënyrë pune, një urdhër), *zbatim* m. Mungon te G. Meyeri. Bashkimi *zbató*, *me zbatue* «disbrigare», *zbatim* «applicazione». Weigandi 103 e jep me kuptimin «rrezoj, shemb, bitis», dhe bashkë me rum. *zbat* «shkund» *mã zbat* «përpëlitem, rrekem» e bie të ardhur prej një lat. *exbattuo* «rrah».

Spiegim i pamundur. Përdorimi në fillim i kufizuar i fjalës dhe dëshmimi i vonë i saj nuk flasin në të mirë të një lashtësie të madhe të saj e me këtë të një burimi prej latinishtes. Më anë tjetër një \**exbattuo* nuk dëshmohet gjëkund në latinishten. Burimi i rum. *zbat* prej asaj, me gjithë se mbrohet te Densusianu I 169 e te Puşcariu EW 1930, në këto rrethana mbetet i pasigurtë; it. *sballare* prov. *esbatre* frgj. *ébatte* etj. që sillen për vërtetim te Puşcariu, nuk jepen te Meyer-Lübke REW, ato janë më fort formime vetiake të këtyre gjuhëve. Edhe për arsye fonetike ky barazim nuk mbahet, sepse lat. *ex-* ka dhënë *sh-* në shqipen. Fjala si e tillë mund të ekzistojë (e afër me *zbaticë baticë?*), po kuptimi me të cilin përdoret duket të jetë i sajuar.

**zbërkó** «shkyej, çaj» (sidomos për bishën kur çan berrat), në Gurzi të Ishmit. Fjalë e paregjistruar nëpër fjalorë. Në tosk. jugore (Gjirokastra) *zbërkohem* «shtrij krahët e këmbët, shtriqem», edhe kjo e paregjistruar. Një folje denominative e *bark-ut*, «i çaj barkun». Me prefiks *z-* të kuptimit antonimik, si *zbath*, *zbërthej*, sh. për këto formime Xhuvani-Çabej BSS 1956 Nr. 4 f. 102. Reduktim i *a-së* së pathekse në *ë* ashtu si te *baltë*: *mbëltoj Beltoja*, *gaz*: *gëzoj*, *valë*: *vëloj vloj* etj.

**zborák** m. «Fringilla». Spiegimet e Kamardës (I 348) e të Dozonit (f. 110) nuk vijnë në vështrim. Stieri (Nr.88) mendon për një afrim me grupin got. *sparwa* gr. *σπέργυλος* «harabel». G. Meyeri 482 më fort se ta vendosë te ky grup fjalësh parapëlqen një spiegim prej sllavishtes, serbokr. *čvorak* «Sturnus, shturë.» Puşcariu (EW 1933) bën një afrim me rum. *zbor* «fluturoj». Selishçevi nuk e numëron *zborak-un* ndër sllavizmat e shqipes, po Skoku (Jugosl. Encikl. I 162) e merr si një të tillë. Si e kemi shtjelluar dhe në BSS 1954 Nr.3 f.61, spiegimi i drejtë i fjalës gjindet te Kristoforidhi 368: *zborak* nga *borë*, *zborë*, si «zog bore»; khs. spiegimin e Mannit «një zog që zbret nga malet kur bie borë, me zverk të zi e me bisht si të dallëndyshes».

Trajta *bors*, me *-th* deminutive *borsëth* e dialekteve arbëreshe të Italisë, me *-zë borëz*, ka dalë nga *borë*; poashtu *borcak-u* i Gazullit (f. 482), që është një zgjerim *borc-ak*; sh. *bors*. Trajta *zborak*, me zgjerim më *-ës zborakës*, formuar nga *zborë*. Në dialektet ku borës i thonë *vdorë*, ky zog quhet *vdorsi* (Kruja), *vdorsku* (Peqini). Këto variante dëshmojnë se ky emër zogu ka dalë nga trajtat e ndryshme të borës, siç janë *borë*, *zborë*, *vdorë*. Edhe në të tjera gjuhë një lloj finku e ka marrë emrin prej borës; khs. lat. *Fringilla nivalis*, frgj. *pinson de neige*, *nivereau*, gjerm. *Schneefink*.

**zbruj** «bëj të butë një gjë të thatë a të fortë», *zbruj biskotën në qumësht*; figurshëm «sqaq së rrahuri»; *zbruhem*, si në këto *dardhë zbruhën vetiut*. G. Meyeri s'e ka në Fjalorin etimologjik; në AS V 106 shënon pas Reinholdi *zbruh* «bëj të prishet, të motohet nga koha» për shqipen e dikurshme të Athinës, po e lë fjalën të paspieguar. Ashtu dhe Weigandi 103, i cili sjell për geg. jugore *zbrúj zbrúna* «bëj të butë (me të ngjeshur

ose me të rrahur». Kristoforidhi e jep për të folët e Elbasanit, si fjalë të vjetëruar, me trajtat *sbruj* e *cbruj*, në shprehjen e *sbrûna së rrafëmi*. Edhe Lambertzi jep (për geg. veriore) *shpinen me ja zbrû* e *e zbrune në dru* «e sqaqën në dru». Lidhet me *brumë*, me kuptimin «e bëj të butë si brumë». Morfologjikisht *zbruj* është opoziti i *mbruj*, po me një z-më fort intensive se antonimike. Trajta *zbruh* e tosk. jugore e ka mbarsën nga mesore-pësorja *zbruhem*, ashtu si *deh* «dej» nga *dehem*, *mah* «maj» nga *mahem* etj.

**zdërgjâhem** «shtrihem pa turp sa gjatë gjerë». Mungon te G. Meyeri. E ka sëpari Kristoforidhi, si *τεντόνομαι παρά τὸ σύννηδες, ἀσυστόλως* (ἐν ὥρᾳ μὴ ἀπαπαιτουμένη), *ἀλλοῦ ἐξαπλόνω τὴν χεῖρα καὶ ἀλλοῦ τὸν πόδα ἀπρεπῶς*: *shih si zdërgjâhet ay djalë përpara pleqsh, përpara të mëdhenjsh*; Bashkimi «portarsi o condursi indecentemente», Weigandi 104 «sich flegelhaft, unehrerbietig betragen (vor älteren Personen), sich rekeln». Sikurse e kemi shënuar shkurt dhe në BSS 1956 Nr. 4 f. 102, është një kompozit *zdër-gjâhem*: *zdër-* prefiks e *gjâhem* e afër me *gjanë*. Pra «shtrihem sa gjatë gjanë». Prefiksi *zdër-* ka një funksion intensiteti e një kuptim drastik. Morfologjikisht duket të ketë dalë nga sonorizimi i *stër-it* në të dyja konsonantet nistore. Një tjetër folje formuar me të e që afrohet në kuptim me *zdërgjâhem*, është *zderhalem* «kaloj kohën me qejfe e me gosta».

**zdirgjem**: sh. *dergjem*.

**zdramë** f. «plaga që i bëhet kafshës në kurriz nga të vrrarët e samarit». Mungon te G. Meyeri, me gjithë se e jep Kamarda (II 139) për arbërishten e Sigelisë, si *sdramë* «guidalesco, o grande piaga in generale», duke e afuar ai me gr. *τραῦμα* «plagë, lëndim». Është fjalë e mbarë gjuhës, jo vetëm e gegërishtes si shënon Kristoforidhi. E ka për geg. veriore ndër të tjerë Junku me Bashkimin. Për geg. jugore Weigandi 104, i cili e lidh përbrenda gjuhës me foljen *me zdrâ* «bëj të ënjtet (nga të rrahurit)» *zdrânem* «fahem së ngrëni, mbush barkun plot», po pa e gjurmuar më tej burimin e fjalës. Edhe Bashkimi *m'u zdrâ me mish* «me e fry barkun me mish». Në geg. veriore emri më fort si *maskh. zdram-i*, edhe me kuptimin «lym», ndyrësi», khs. *zdram* e *lmashk Criticus* HD V 70, sh. edhe HD X 459. Kështu edhe Lambertzi, *zdram-i* «Schmutz». Te Leka IV 80 *zdram* edhe folje, *Tue zdramë gjinden m'heshtë çelikut*. Në Mat *zdram* m., po figurshëm *zdramë* f. «emën përbuzës që i veket ndonji grueje me ftyrë të prishun repë», pranë foljes *zdrâj* «prish lëkurën», e ka *zdranë në ftyrë me shkopt*, e ka *zdranë dega degë* «kur dy degë përkohen e repin lëkurën njera tjetrës», K. Ulqini BUST SSS XV Nr. 3 f. 216. Për arbërishten e Italisë, përveç vargut të cituar të Kamar-dës, khs. edhe ato të De Radës e të Skiròit që jep Giordano, si edhe e *kishëjën po eshtrat e likurën e ishën të plota me sdramë*, Fjala e t'in Zoti II Nr. 35 f.3.

Për hetimin e burimit të fjalës është me rëndësi të dihet kuptimi i mirëfilltë i saj. Ky, mbi dëshminë e përbashkët të dialekteve, edhe t'atyre të diasporës së Italisë, është ai i një plage shkaktuar nga të vrrarët e lëkurës. Prandaj *zdramë* mund të jetë e afër përbrenda gjuhës me *dregëz* «kore e plagës» dhe bashkë me këtë t'i përkasë rrënjës indoeur. \**der-* \**der-* \**drē* «rjep, çaj»: gr. *δέρω*, «rjep» *δερμα δορά* «lëkurë», bret. *dervoeden* «urth», ags. *teter* «puçriza mbi lëkurë», lit. *dedervinē* «urth»,

sll. e vj. kishtare *derp* «shkyej, rjep», ind. e vj. *dar-dru-* «lloj urthi i lëkurës» etj., sh. për këtë familje fjalësh Pokornyn I 206 vv. Morfologjikisht *zdramë*, si *z-dra-më*, paraqitet e formuar me prefiks *z-* e sufiks *-më*, mbase si një postverbal i *zdrâj*, *me zdrâ*. Te *-dra-* reflektohet pas gjase një bazë \**dró-*, me *o* të shkurtër, bazë me shkallë të një apofonie kualitative ndaj indoeur. \**drē-*. Me *zdramë* «lidhet mbase dhe *zdralë* «zhul, lerë në trup e në petka», në Malsi të Madhe (Gj. Shkurta) *zdrale* «zhele, rreckë».

*zëndunë* (*me*) «prosecare, me pre kurma-kurma». Për këtë fjalë që del si një *ἀπαξ εἰρημένον* te Bardhi, G. Meyeri 482 mendon — me dyshim — një burim prej turq. *üzendi*, perfekti i *üzenmek* «me punue me kujdes, me u përkujdësë». Sikurse e kemi shënuar dhe më lart (te *gdhend*), kjo fjalë nuk është gjë tjetër veçse *me dhëndunë* «me gdhendun». Te Bardhi (disa herë dhe te Budi) germa *ε*, e cila shënon normalisht tingullin *z*, disa herë është përdorur si shenja e spirantit interdental të zëshëm *dh*. Kështu e gjejmë p.sh. (f. 27, 33, 38, 107) te *dhelëpënisht*, *idhujtë*, *dhambëtë*, *urdhënuem*.

*zet*, në *njëzët*, *dyzët*, në disa dialekte të Greqisë e t'Italisë edhe *trezët* «60», *katërzët* «80», në Itali vise-vise edhe *trezetedhjet* «70», *katërzettedhjetë* «90»; *trezët* «60» dëgjohet rastësisht edhe në Shalë e Shosh e nëpër këngë edhe në Oblikë të Sipërme. Për Greqi Reinhold 22 e te Antologjia e litografuar 32, për Kalabri edhe Rohlf's AIS II 301 vv. Që prej Pottit (Die quinare und vigesimale Zählmethode, 1847, f. 102) e këtej e afrojnë thuajse përgjithësisht me fjalën indoeuropiane për «njëzet», ind. e vj. *çati-h* në *vimçatīh*, av. *vīsaiti*, arm. *k'san*, gr. at. *εἴκοσι* dor. *ἑξάκτι*, lat. *viginti*, irl. e vj. *fiche* etj., këto nga një bazë \**uī-kmti* «dy dhjetshe», *zet* nga një \**gānti-* ose \**k'mt*, me zhvillim të sonantit nazal *ŋ* në *e*, Bopp 512, G. Meyer 483 e AS III 17, Brugmann I<sup>2</sup> 406, 566, 630, Reichelt IF 40, 65 shën. 1, Vasmer I 39, Jokl LKU 103, Barić Arhiv I 217, Hymje 35 shën. 2, Walde-Pokorny I 313, Walde-Hofmann II 789 (me literaturë), La Piana Intorno 11, 12, 31, SLA I 22, 40, Cimochowski LP II 232. Vetëm Boisacqu 221 nuk përmend në këtë mes fjalën e shqipes As Frisku I 453 v.

E mbarë gjuhës. Buzuku (p.sh. LX=LXX, Gjenezja 6,3) e të jenë *dittë e ti një qind e njëzet* «erunteque dies illius centum viginti annorum». Si e kemi shtjelluar edhe gjetkë (BSS 1952 Nr.3 f.39vv., Z.f. Phon. u. allg. Sprachwiss. 9, 206 vv.), është një gjë me rëndësi që *zet* si e tillë nuk ekziston fare në gjuhë; ajo është një abstrakcion i gjuhëtarëve, dhe të *zetëtin vit* e Skiròit (Canti tradizionali 357) është një ndërtime i këtij poeti. Në këtë mënyrë fjala edhe kuptimisht nuk hyn në grupin e lat. *viginti*, sa kohë që te *njëzet*, *dyzet* pjesa tematike *zet* do të thotë «njëzet», te *viginti* (*vi-ginti*) me shoqe pjesa tematike do të thotë «dhjetë». Edhe fonetikisht nuk ecën ky barazim, i cili operon me disa zhvillime të pavërtetuara për shqipen, si (te \**kmt-*: *zet*) ndrimi i *k-së* në *z* e i *m-* ose *ŋ-së* në *e*, ruajtja e *t-së* fundore etj. Çështja zgjidhet kur pranojmë rregullën tonë fonetike që *z-j* a nistore në disa fjalë të lashta të shqipes reflekton një *i-* indoeuropiane. Kështu *zet*, si vazhdim i një baze parashqiptare \**ieuk-t-*, me kuptim të parë «çift, çift dhjetsish», është përfaqësuesi i emrit indoeuropian të zgjedhës në gjuhën shqipe. \**ieug-*, në het. *iugan*, ind. e vj. *iugá* «zgjedhë, çift» *iugalá-* «çift», gr. *ζυγών* «zgjedhë» *ζεύγυμι* «mbrej, lidh, bashkoj», lat. *iugum*, got. *juk* etj. Si një pjesore e moçme më *-t* e me shkallën apofonike të plotën *eu*, *-zet* i përgjigjet më fort gr. *ζευκτός* «i vënë në zgjedhë, i mbretur, i bashkuar».

Asimilim i grupit *kt* në *t*, si te *natë*: lit. *naktis*, *tetë*: gr. *δῆτώ*. Sistemi vigesimal i numërimit mbizotëron në shqipen edhe te *dyzët*, vetëm geg. veriore thotë *katërdhetë*. Për numërimin vigesimal si një nga mbeturinat e substratit paraindoeuropean në shqipen sh. Joklin Reallex. d. Vorgesch. I 93 dhe vrejttjet tona BUST SSS XVI Nr. 4 f.124, 141, SA I 1 78.

**zëmër zamër** f. «pasdrekja, iqindia», edhe *zëmërherë*, si në *drekëherë*. Çamërisht pas Pedersenit 161 *mëzëmër*, do ha *mëzëmërin*, në Lëkurës të Sarandës *zëmëri* «buka e iqindisë», *zëmërij* «ha iqindi». Del që te Bardhi: Prandare *Me drekunë, o me zamëruem*. Në kundërshtim me Hahnin, i cili duket se e vinte baras me *zemërë-n*, emrin e pjesës së trupit, M. Meyeri (f. 483, AS IV 41) me të drejtë sheh aty dy fjalë të ndryshme, po *zëmër zamër* e quan të errët për nga ana e burimit. Ndërsa në toskërishten *zëmër* në shumë dialekte përbën homonimi me *zemër*, gjë që do të ketë shkaktuar dhe tërheqjen e asaj në përdorimin gjuhësor, në gegërishten nga *zamër* e *zemër* shihet qartë se kemi të bëjmë me dy fjalë të ndryshme. Një nga ato fjalë të shqipes me *z-* prej indoeur. *i-* në ballë të fjalës. Si refleksi i një baze parashq. *\*iamerā* ose *\*iemerā*, e afër m gr. *ἡμέρα* «ditë» dhe arm. *awr* «ditë» nga një *\*āmor*, sh. BSS 1952 Nr. 3 f. 46 vv., Z. f. Phon. u. allg. Sprachwiss 9, 214 vv. Një nga konkordancat e veçanta të shqipes me greqishten e armenishten, khs. dhe *vend, verë venë*.

**zgafelle** f. «galeri; tunel; shpellë». Mungon te G. Meyeri. Del sëpari te Bashkimi, *zgafelle* «traforo, cava», *me zgafellue, me zgafullue* «traforare», *i zgafelluem* «traforato» *t'zgafelluem* «traforo». FGS *zgafulloj* «hap një gropë», Kristoforidhi *zgafulloj krahanorin* «hap krahanorin», *zgafullohem (jam zgafullue prej vape)*. G. Meyeri 484 jep vetëm (pas Hahnit 113) *zgafulloj (krahanorin)* «hap», *zgafulloj alipsanën* «hap, vë përpara (reliken)», dhe nuk jep spjegim etimologjik. Eugge (BB XVIII 186v.) e bie të ardhur nga një lat. e rindërtuar *\*dis-co-affibulare*, prej *affibulare* «kap me karficë». Treimeri (KZ 65, 93v.) prej *zgafulloj* rindërtton një *\*gafullë* «kraharor», këtë e çon te një bazë *\*guhaupslā* dhe e afron fjalën me lit. *žiupsnis* «një grusht, një dorë plot», rus. *guba* «gji deti» etj. Në kritikën e tij (IJ XXIV VII 217) Jokli pa se *zgafulloj* afrohet përbrenda shqipes me *zgafelle*; ai sheh aty një huazim latin-roman të shqipes, po pa i vënë gisht burimit të fjalës.

Fjalë dialektore e gegërishtes, emri i Veriut, folja me *-u-* e Shqipërisë së mesme. Morfologjikisht *zgafulloj* është një verbum denominativum i *zgafelle-s*; *zgafelloj* që dëshmon Bashkimi për Veri, dha *zgafulloj* në geg. jugore, idealisht nëpër një trajtë *\*zgafëlløj*, me ndrim të *ë-së* në *u* pranë një labiali, ndrim i shpeshtë në këtë dialekt sidomos në pozicion përpara theksit, sh. BUST SSS XVI Nr. 1 f. 222. Etimologjikisht *zgafelle* është e afër me *gërfej zgërfëj* pl. «shpella me dy grykë, hihet më një anë e delet më tjetrën anë» e me *gërfyll* me të njëjtin kuptim. Sikundër është shtjelluar te *gërfëj, gërfëj* është një kompozit me *gër-* i *fej-ve*, shumë *i fyell-it*; *zgërfëj* kompozit me *zgër-*, e *gërfyll* është *gër-fyell*; të gjitha nga *fyell* me kuptimin primar të kësaj fjale, që është «tytë, zgavër, gyp» (sh. *fyell*). Ashtu dhe *zgafelle* është *z-ga-fell-e*: kompozit *i fell* «fyell» me *ga-* = *gë-* në pozicion paratheksor (Xhuvani-Çabej BSS 1956 Nr. 4 f.72), me shtesë të një *z-je (zga-)*, e me formantin *-e* të femëroreve. Në analizë të fundit *-fell fyell* lidhet përbrenda gjuhës me *thellë*.

**zgarbë** f. «zgavër e një druri të madh; trung druri i zgavërt», edhe *zgarbull* m., *zgërbonjë* f. Mungon te G. Meyeri. E jep sëpari Kristoforidhi

për të folët e Përmetit, si *sgárbullë* «një dru që është ngrënë zëmëra përbrenda, si rrapë etj.»; Tase *sgarbull xgarbull* m. e *sgárbullë xgarbullë* f. «gufallë, sgavrë (sidomos për drurë, për lisa etj.), dru, lis, pemë me trungun gllovë, me trunk të sgerbuar»; Manni *zgarbë* «pit, hole, cave»; FGS *zgarbë ullini*; në Shpat *zgárb-a*; *zgërbonjë*, te Kristoforidhi për Berat e Frashër, *sgërbonjë drurit*, f. 433 për Berat *cgërbonjë*. Pedersení (f. 40, 120) *skërbonjë, xgërbúnjatë* «verfaulte Bäume, dru të kalbur». Edhe te N. Frashëri, Ist. e Skënd. 40. Në Seman të Fierit *zgërbonjë-a* «guvë në trupin e një druri të kalbur» (J. Thomaj BUST SSS XV Nr.4. f. 153), në Peqin *zgërbôj-ja* «dru i zgavërt përbrenda» (Çeliku SF XIX = II Nr. 4 f. 125). Në Vuno të Himarës *kërbunjtë* mshm. «cungjtë e ardhive». Në Kalabri *sgárbula* «buco in un albero», veçanërisht në Frasnit *zgarbuconjë* pas Giordanos «legno o tronco d'albero con grande buca corrosa dal tarlo o dal tempo», figurshëm *zgarbocull* m. «nano, omiciattolo, shkurtabiq». Morfologjikisht *zgarbë* paraqitet e formuar me prefiks s- sonorizuar me rrugë asimilimi pranë g-së; *zgarbull* zgjerim me sufiks -ull. Në toponiminë e Kallaratis (Kurvelesh) *Shal'e xgárbullës, Lugu xgárbullës*, emër i një lugu që ka pasur lisa shumë të vjetër e me zgarbulla (R. Memushaj). Te Tasi edhe folja *zgarbulloj* «gërryej, zemrën e drusë, e bëj zgarbë»; te *zgërbonjë* reduktim i rregullt i a-së së pathekse në ë, dhe zgjerim me sufiks -onjë, sh. dhe Xhuvani — Çabej Prapashtesat 74; *zgërbonjë* ndaj *zgarbë* si *shkëlbozë* ndaj *kalb*.

Kjo fjalë e paspieguar më parë, më fort se - si një mbeturinë e «ilirishtes së Alpeve» — e krahasueshme me grupin e fjalëve alpine ligur. *garbo* «anfratto, antro, grotticella» *garbu* «albero incavato», frgj. (Hautes-Alpes) *garbo* «gros tronc d'arbre creux» *garbas* «arbre creux presque pourri» etj. (BUST SSS XVI Nr.4. f.13vc., SA I 1 73), është një formim i brendshëm i shqipës. Si «dru kalbsiq, zgavër e kalbur në dru» është një postverbal i *kalb*. Ndryshimi i formës (sonorizim i k-së nistore, ndrimi i likuidës l në r) është i njëjti me atë që vihet re te një tjetër rrjedhojë e foljes *kalb*, te *gërbulë*. E sikundër që pranë *gërbulë-s* ka dhe *këlbulë*, ashtu edhe pranë *zgarbuconjë-s* në Kalabri sipas Giordanos ka dhe *kalbuconjë* «legno o tronco infracidito». Për zhvillimin kuptimor nga «kalbësirë» në «zgavër druri» do vënë re se edhe një tjetër postverbal i *kalb*, *shkëlbozë*, ka arritur në kuptimin «lëkurë e drurit». — Sh. edhe *zgerbe*.

*zgargull* m. sh. *gargull*.

*zgerbe* f. «tenjë». Del vetëm te Budi (DC 117, SC 227): *i cili... e bre nierinë ndë zemërë, posi krymbi drënë, e posikur zgerbëja pëtëkunë, o dryshku hëkur(r)inë; Mos e mbëlidhi vetë vistarrë përmbi dhët, ke e bre dryshku e zgerbëja, e e rëmonjënë kusarëtë, me e vjedhunë*. Buzuku (XLI/2, Mateu 6, 19) *E mos vini ar mos vistar këha mbë këtë jetë, qi tenja e bre e të ndryshkëtitë, c qi kusarëtë e nizerënë e vjedhënë* «Nolite thesaurizare vobis thesauros in terra: ubi erugo et tinéa demolitur, et ubi fures effodiunt et furantur». Si emri i një insekti që ha petkat e që bën bira në to, e afër me *zgarbë zgarbull zgërbonjë*. Khs. për kuptimin gjerm. (dial.) *Schabe* «tenjë»: *schabe* «kruaj, gdhend». Leotti ka *zgerbë* «zgavër» (në një dru). Kjo për nga forma shkon me *zgerbe-n* e Budit, për nga kuptimi me *zgarbë zgarbull zgërbonjë*. Morfologjikisht *zgerbe* është shumësi metafonik e i singularizuar i *zgarb zgarbë-s*, te FGS *zgjerbe* me palatalizim të guturalit, sh. vrejtjet tona ShS 174.

**zgerdhë** f., në *zgerdhë mushkënie* «bronke e mushkërive», pas Gazullit në geg. veriore të Pultit. Trajtë metafonike e një *zgardh*-i, sikundër del te *zgerdhaqët* «zgorç» e mbase dhe te *Zgërdhësh*; khs. edhe foljen *zgardh* «hap, çel, prish gardhin» në arbërishten e Siqelisë (te Z. Skirò). Mbase përdorur si shumë, *zgerdhët*. Si njëjës do të ishte një shumësi i singularizuar, sh. vrejtitet tona ShS 163v. Kuptimi i parë i fjalës është «golle, vend i hapur».

**zgerdhaqët** (i) mb. «zgorç, për një gur me golle përbrenda». Fjalë e geg. veriore, te Gazulli «gur zgërrojç, me plasa a krisa e gropza mbrendë». Po nga ai *zgardh*, kompozit i *gardh-it*, që gjindet te *zgerdhihem* e *Zgërdhësh*, e m'anë tjetër te *zgerdhë*. Sufiksi *-aq* formon ndër të tjera dhe mbiemra prej emrash (*andaq, flamaq, hirraq* etj.), Xhuvani-Çabej Prapashtesat 18. Këtu zgjeruar me *-ët*.

**Zgërdhësh** m., emër i një katundi afër Krujës, ku mendohet të ketë qenë qyteti Albanopolis që përmend Ptolemeu, te Hahni (I 120v., Reise Drin-Wardar 126) shkruar *Skurtësh*, sh. edhe Sufflayn, Städte u. Burgen Albaniens 7 shën. 8, me literaturë. Një formim i *gardh-it* me prefiks *z-* (nga *s-*, me rrugë asimilimi), e me sufiks *-esh*, formant i gjallë në toponiminë e një zone të hapët të Gegërisë, ç'merr prej anëve të Kurbinit e gjer në krahinë të Martaneshit, prej trevës në veri të Krujës e gjer në anët e Elbasanit, sh. *arbëresh arbenësh* te *arbër arbën*. I mundur është ndërkaq dhe një burim i drejtpërdrejtë nga *zgardh*, qoftë si emër (sh. *zgerdhë*), qoftë si folje, në arbërishten e Siqelisë «hap, çel, prish gardhin», ku hyjnë edhe *zgerdhaqët* e *zgerdhihem*. Me reduktimin e *a-së* së pathekse në *ë Zgërdhesh* paraqitet si një emër vendi më i vjetër se *Gardhiq Kardhiq*. Nga kjo anë ai emër qëndron në një shkallë me disa të tjera rrjedhoja të *gardh-it*, si *zgerdheshem, zgerdhihem, ngërthej*. Trajta lokale *Zgërdhësh* (Gazetteer 201) paraqet labializimin e *ë-së* në *u* në rrokje paratheksore.

**zgerdhihem** «zbardh dhëmbët, qesh me të tallur». Këtë fjalë të gegërishtes G. Meyeri 306 e jep si *zgerdhî dhamëtë* dhe *fiku u zgerdhî* «fiku plasi, u ça», dhe e lidh përbrenda gjuhës me *ngordh*. Është një denominativ i *gardh-it*, dhe mund të ketë dalë drejtpërdrejt nga *zgardh* «hap, çel, prish gardhin», që ruhet në arbërishten e Siqelisë. Zgjerim foljor me *-inj, -ij*, si *mbëllij: mbyll, kërpinj: kripë*; sh. për këto forma Joklin LKU 89, khs. dhe *hyj hij*. Me reduktimin e *a-së* paratheksore në *ë zgerdhihem* paraqitet si një formim mjaft i vjetër i *gardh-it*, ashtu si *Zgërdhësh, i zgerdhaqët e ngërthëj*. Një variante e *zgerdhihem* është *zgerdheshem*, mbase nën ndikim të *qesh, qeshem*. Këndeje u formua me rrugë retrograde *ngërdheshem* «përdredh buzët a shtrembëroj fytyrën për të përqeshur një tjetër». Aty hyn dhe *ngërdhucem* «ngërdheshem, përdredh buzët» me *kërveshem* «shtrembëroj buzët, në shenjë shpotie, përbuzjeje», kjo me ndërhyrje të *vesh-it*, khs. *i shkoi goja vesh më vesh* «u shkull së qeshuri». Nga një kryqëzim i *zgerdhihem* me *qesh qeshem* ka dalë *zgerqeshem* te FGS. Khs. edhe *me sy të zgerdhucun* «me sy të zgurdulluar» te Manni. Një familje e tërë foljesh, që burojnë në analizë të fundit prej *gardh-it*. Kuptimi i përbashkët i foljeve është «hap, çel». Andej rrjedh dhe *fiku u zgerdhî* «fiku plasi, u ça». Pa prefiks *z-* hyn aty, duke u afuar me *fiku u zgerdhî*, edhe *gërdhinj* «bëj bimët të plasit (prej vape) e «bëj duart të plasariten». Këtë fjalë të Mitkos G. Meyeri

123 pa të drejtë e bashkon me (më) *gërditet* «më vështiret, më vjen të ndotë», e cila buron prej sllavishtes.

**zglëng** m. «gërrqe, hurbë». Këtë fjalë të ligjërimin të ishullit Poros në Greqi Reinholdi (Glosari 33) e jep bashkë me shprehjen *sterrmë* (shtermë?) *akoma një zglëng*, pranë sinonimeve *zgunj* e *zguith* të ishullit Specia. G. Meyeri 484 i nxjerr të tria fjalët prej sllavishtes, sll. e vj. kishtare *poglnati poglbiti* «deglutire»; veçanërisht *zgunj* prej skr. *gunuti* «pi një hurbë», *zglëng* prej bullg. *glbitk* «gërrqe, hurbë». Selishçevi nuk i shënon këto ndër huazimet sllave të shqipes.

Refleksi i fjalës bullgare në shqipen është *gëlltit*. Si e kemi shënuar dhe te Xhuvani-Çabej BSS 1956 Nr.4 f.102, *zglëng* është një formë me *z-* e *gllënkë* «një gërrqe ujë, një hurbë verë etj.», në tosk. jugore (Gjiro-kastër) e *piu gllënk*. Ndërkaq në Vlorë ka *zglëngkë*, formë më e afër me atë të Greqisë. Të gjitha formime onomatopeike. Të tilla duket të jenë edhe *zgunj* e *zguith*. Te këto *u-*ja mund të ketë dalë nga *l-*ja velare (\**zglënj*, \**zglëjth*), dukuri mjaft e shpeshtë në shqipen e Greqisë.

**zgobinalle, zgobinetë** f.: sh. *gomën*.

**zgrrip** m. «anë, buzë, qenar», në *zgrrip të shkambit, mos rri në zgrrip; plot deri në zgrrip* «plot gjer në grykë», figurshëm *me zgrrip* «me të pakë, nga pak, me kursim», sh. dhe FGS. E afrojnë, që nga G. Meyeri 205 e këtej, me *krep* e *shkrep* «shkëmb», sh. Joklin Studien 35, LKU 116.

Del që te Budi (SC 146): *sesā zgrrip e m perikullë janë* (gabim shtypi *perillë*). Rrjedhoja janë i *zgrripët* «i kursyer, që ha e pi me masë, që ka qokë, ngaqë ka pak, ngaqë s'ka», *zgriptas* «me ekonomi a me kursim të tepëruar», *zgriptoj* «sa zë fill, shpie gjer në zgrrip, gjer në fund; shpenzoj me zgrrip, nga pak». Bageri 35 *zgriptinë* f. «cekë, ceklinë». Fjala i *skrimtë*, në *nieri i skrimtë* «i përkormë në hae e në pije», që jep Gazulli për Mirditë, me sufiks *-m* që ndrohet shpesh me *-b*, tregon se edhe *zgrrip* ka nisur me *sk-* e ka pësuar në Veri sonorizimin e këtij grupi konsonantik, duke u larguar kështu nga *krep shkrep*. Raportin fonetik *e : i* në *krep shkrep : zgrrip* G. Meyeri e Jokli nuk e spiegojnë. Është vështirë të pranohet (me Camajn 44) zhvillimi i një fjale dialektore si *zgrrip* prej një baze \**z-grp-*, pra një ndrim indoeur. *r*: shq. *ri*, që është i prehistorisë së shqipes. Më afër menç është një zhvillim i brendshëm e dialektor *e:i*, mbase nën ndikim të shumësit. Me largimin e formës u krye dhe largimi i kuptimit nga *krep shkrep*.

**zgrof** m. «stomak i njeriut e i bagëtisë.» Mungon te G. Meyeri, e ka sëpari Bashkimi, me kuptimin «stomaco, parte superiore del ventre»; Gazulli e jep për të folët e Pukës e të Mirditës. Jokli (Arhiv I 44) e bie të ardhur prej lat. *scrobis*, te Prisciani *scrobs*, «gropë, vulva», grupi *bs, ps* i së cilës u ndrua në shqipen me *f*. Kemi të bëjmë sipas tij me një element të latinitetit ballkanik, meqë e ka dhe rumanishtja, si *scorbură* «shpellë, zgafelle», arom. *scrobu*.

Fjalë mund të themi e mbarë gjuhës, meqë e ka edhe Myzeqeja, me kuptim mbiemëror, «zgavër, zgavriq», për trungjet e drurëve, është *zgrof trungu*. Kuptimi i parë i fjalës është «zgavër, golle», ngushtimi si emërtim i stomakut është i geg. veriore. Etimologjia latine paraqitet fort e dyshimtë; ajo mungon dhe te Meyer-Lübke REW 7747, i cili çfaq rezerva edhe për pranimin e arom. *scrobu* si refleksi të fjalës latine.

Fonetikisht huazime të tilla si *shkallë*, *shqa*, *shkretë* dëftojnë se në lat. *sk-*, *skr-* *s*-ja në shqipen është ndruar në *sh*. Nga pikëpamja formale e leksikore do shënuar se *zgrof* nuk është e izoluar në gjuhë. Kristoforidhi ka *m'u zgërrop barku së pangrani* me spjegimin «barku m'u bâ gropë prej së pangrani», me *rr* për punë të geminacionit ekspresiv, i natyrshëm në një fjalë të sferës të së ngrënit, kurse FGS këtë fjalë e jep me trajtën *zgropem*. Edhe më rëndësi ka që pranë *zgrof*-it ekziston po me atë kuptim edhe *zgrop*. Shihet kështu që *zgrop* e *zgrof* lidhen përbrenda gjuhës me *zgropoj* «gërmoj, bëj gropë» dhe hyjnë nënëfund te *gropë*. Për anën kuptimore khs. gr. *κοιλία* «bark»: *κοιλός* «i zgavërt», të cilën e përmend vetë Jokli. Ndrimi *p : f* është dialektor, khs. *thupër: shufër*. — Me *zgrof* afrohet dhe *zgrovót* m. «përbindsh; lugat, vampir, me *i hapë sytë si zgrovot*; njeri përpis qi s'ngihet kurrë», që jep Gazulli për Malsi të Madhe. Për sufiksin *-ot* sh. Xhuvani-Çabej Prapashtesat 81, shtu edhe *sqepót*.

**zguith** m.: sh. *zglëng*.

**zgunj** m.: sh. *zglëng*.

**zگردullôj** «hap sytë kokërdhok, nga frika a nga habia». Mungon te G. Meyeri, del te Leotti, te Manni e në burime të tjera që përmend ky i fundit; në të folët e Dangllisë *kolla i zگردullonj sytë*, Floqi BUST SSS XII Nr.3. f.150. N. Frashëri (Luletë e verësë IX varg 11) ka *Ata sy të zگردulluar*, Manni edhe *zگردhëlloj*. Për hetimin e historisë së fjalës peshon kjo që ajo në arbërishten e Italisë tingëllon *zgardhëllonj*, *zgardhullonj*, te Giordano e para me kuptimin «spalancare, aprire; dissipare» (*klëshedra, me sytë keq zgardhëlluar; i mjeri plak zgardhëlloj sytë*), e dyta «spalancare, stralunare, sgranare, aprire» (*sytë zgardhullomej*, Bilotta), *zgardhuluer* «spalancata», dhe te Bilotta, Versi lugubri 27. Në Frasnit të Kalabrisë sipas Giordanos edhe *zgardhull*, në *la derën zgardhull* «ha lasciato la porta spalancata», *qëndroi me sytë zgardhull i vdekuri* «il morto è rimasto cogli occhi aperti». Në këto rrethana shihet se *zgardhull*, me rrjedhojat e saj *zgardhullonj zgardhëllonj e zگردulloj*, si një zgjerim me sufiks *-ull*, lidhet me *zgardh* «hap, çel, prish gardhin», që u pa më sipër te *zgerdhë*, *Zگردhësh* e *zگردhnhem*, e në analizë të fundit me *gardh*. Arbërishtja e Italisë, si shpeshherë, ka ruajtur edhe këtu një formë leksikore më të vjetër. Te *zگردulloj* e Shqipërisë vihet re një zhvillim i mëtejshëm, me labializim të *u*-së në rrokje paratheksore e me ndrim të spirantit *dh* në okluzivin përkatës, mbasi ishte bjerrë primitivi *zgardh* si dhe ndjenja e lidhjes së foljes me *gardh*-in. Aty hyn edhe *sgërdë* «njeri që ka sitë sipër prierë; βλοσυρός. sévère; féroce; épouvantable» që jep Reinholdi (Glosari 27) për shqipen e Greqisë.

**zگردhë** f. «fundi i zorrës së trashë». Këtë fjalë. që mungon te G. Meyeri, Jokli (Mél. Pedersen 141 vv.) e afron përbrenda gjuhës me *zorrë*, me *angërr* e me *ngranë*. Sipas tij *zگردhë* prej një baze \**dz-gur-dā*, formë apofonike me dy të tjerat. Të gjitha prej rrënjës indoeur. \**guer-*, \**gúer-* «përpj»: ind. e vj. *gírati* «përpj», lat *vorare*, gr. *βορά* «të ngrënë» etj. Etimologji e pranuar te Pokorny I 474.

Kjo fjalë lidhet pikësepari me *zguer zgori* m. «zgavër, golle; diafragmë (te Gazulli), «zgavra e stomakut» (FGS), me *zguroj zgurtoj* «çel zguer, çel një zgavër». Afrohet më tej me *zgorkë* «gropë në shtratin e

një lumi, birë e vogël; bark», *zgorkem* «zgrupem», *zgerkoj* «gërryey një dru nga përbrenda, e zgavroj», *zgortoj* «zgorkoj, zgavroj», *zgorç* «zgavër, i zgavërt» e ndonjë tjetër. Kuptimi i parë i *zgdurdhë*-s jo «përpjij, përpis», po «zgavër, golle, birë».

**zgjedhë** f.: *zgjedhōj* «mbrej (kaun) në zgjedhë», si term gramatike «koniugoj», *zgjedhim* m. «koniugacion». Fjalë me etimologji të diskutuar. G. Meyeri 484 e spiegon nga gr. e re ζεύγλα ζεύλα e cila sipas tij dha *zgjedhë* duke kaluar nëpër shkallët *zegla zgjella*. Jokli përkundrazi (Studien 99v.), duke u mbështetur te trajta *zgedhë* e Junkut e e Bashkimit, mendon si bazë të fjalës një \**zgedhë*. Kështu e lidh këtë përbrenda gjuhës me *lidh, lidhe* «rryp pëlhure», e më tej me lat. *ligo,-are*, lit. *laigōnas* «vëllai i gruas». Etimologji e pranuar te Weigandi 104 e te Walde-Hofmann I 728. Nga një bazë \**zgedhë* nisen dhe Barići (I 119, Hÿmje 43) e Pisani (Giorn. della Soc. asiat. ital. nuova serie III 5), të cilët ndërkaq e afrojnë fjalën e shqipes me arm. *luc* «zgjedhë». Kundërshtim te Jokli, sh. Walde-Hofmann në vendin e cituar.

Sikundër e kemi shtjelluar dhe në BSS 1952 Nr.3 f.41 shën. 1, Z. f. Phon. u. allg. Sprachwiss. 9, 207 v. shën. 34, trajta bazë e fjalës është *zgjedhë*, jo *zgedhë*. Me -gj- e kanë edhe ato dialekte që grupin *gl* e ruajnë të pandryshuar, siç është çamërishtja. Ashtu e ka dhe Buzuku, i cili edhe ky grupet *gl kl* i paraqet të ruajtura: *E kështu anshtë ngjënimi qi u kam zgjedhunë, aj ditënë të mundonjë shpirtinë e tî? o aj të prunjë kryetë e tî porsî kau mbë zgjedhët* «Numquid tale est ieiunium quod elegi, per diem affligere hominem animam suam? numquid contorquere quasi circulum caput suum» (XLII, Isaia 58, 5); aty vihet re *zgjedhë* pranë foljes *zgedh*, e cila reflekton një *zgedh*. Dhe Bageri 22 ka *Zgjedho qët*. Kështu bien etimologjitë që nisen nga një trajtë më *zgl*. Në vendet e cituara kemi menduar për një \**zgdhë* si njëjës i mirëfilltë i fjalës, duke dalë kështu *zgjedhë* si shumës i singularizuar, sh. edhe LP VII 198v., ShS 18. Për \**zgdhë, zgjedhë* kemi përsjatur një afrim me fjalën gjermanike frizon, e vj. *gadia* «me bashkue», gjerm. *Gatte* «i shoqi» etj., duke krahasuar për anën kuptimore lat. *coniux: iugum*, got. *gajuka* «shok»; *juk* «zgjedhë»; te elementi fundor i *zgjedhë*-s gjenim sufiks in -dhë. Me *zgjedhë* lidhet *zgedharë-t* mshm. «orioni». Për kuptimin e këtij hyllëzimi khs. lat. *iugulae* «orioni», që e bashkojnë me *iugum*, sh. Walde-Hofmann I 728. Me *zgjedhë* duket se ka lidhje edhe folja *ngjedh*, e cila del vetëm si aorist *ngodha* «ngjesha brezin» te Dara (Kënka e sprasme e Balës 134): *Atë thikëz të ngodha!* «Quel pugnaletto ti cinsi!».

**zgjic** m. «gji i vogël i detit». Fjalë e dialektit të Kavajës, e pargjis-truar nëpër fjalorë. Është *z-gji-ç*, formim i *gji*-ut me *z-* e me sufiks -ç, për të cilin khs. Xhuvani-Çabej Prapashtesat 29. Këtu me kuptim deminutiv.

**zgjollë, zxhollë** f.: sh. *gëzhøjë*.

**zgjua zgjue** m. «koshere bletësh». Për këtë fjalë G. Meyeri 484, mbi dëshminë e *zxhuem* «i zgavërt» e *zxhue* «lugu i dorës», arrin te mendimi që kuptimi i parë është «zgavër», ashtu si quhet zgjoi dhe në të tjera gjuhë; ai e largon idenë e ndonjë afrimi me sll. e vj. kishtare *ulij* «zgjua»; khs. dhe vrejttjet e tij IF 6, 121v., e në lidhje me objektin vetë Haberlandtin Kulturgesch. Beiträge 53. Weigandi 105, duke u nisur nga format *zgjū zgjuni* e *zgjū zgoi*, rindërton si bazë të fjalës një \**zgon* dhe

këtë e bie të ardhur nga një lat. *\*excavone*, prej *cavus* «i sgropuar, i zgavërt». Jokli (IF 36, 109, LKU 286), mbi dëshminë e *sgiue* «i zgavërt» të Bogdanit dhe të *zgue zgoi* «zgjua» të Kristoforidhit, e shpie te një lat. *\*excovo-* «zgavër» (si në port. *covo* «i zgavërt» *cova* «shpellë», span. *cueva* «shpellë» etj.), e cila në shqipen dha në kallëzore një *\*skōn* e më-nëfund *zgjua zgjue*; geg. veriore *zg-jue (zgiue)* sipas tij nën ndikim të sll. *globati* «me zgavruë».

Fjalë e mbarë gjuhës. Budi (DC 221b) *Se u jam posi një zgjuo, Keq i mbrazëtë i j nkotë*. Bogdani (I 36, 17) *Disa male tue kjanë fort sgiue e fort të hollë ndë majet* «alcuni (monti) per essere troppo concavi, et acuti». Për geg. jugore sh. dhe I.H. Hysenin, Kop. letrar I f. 2 e 6. — Kundra një burimi latin të kësaj fjale flasin dhe rrethanat e latinishtes dhe të shqipes. Nga pikëpamja latine vihet re se në asnjë gjuhë romane nuk ka reflekse as të një lat. *\*excavone* as të një *\*excovo-*, kështu që këto baza rindërtohen vetëm për punë të shqipes dhe është vështirë që të kenë ekzistuar ndonjëherë në latinishten. Nga pikëpamja e shqipes një bazë latine që të niste me *exc-* ose *ex-* duhej të kish dhënë në shqipen më fort një refleks me *shk-* ose *shq-* (khs. *shqeme* nga *examen*) se një të tillë me *sk-* ose *zgj-*. Me anë tjetër *zgiue* e Bogdanit, *zgue zgoi* e Kristoforidhit dhe *sa zgoja bjesh kie?* «sa zgoje bletësh ke?» e Nikaj — Merturit pranë njëjësit të shquar *goni* (kumtim i E. Lafes) shpien te një *\*glon-* si formë bazë e fjalës. Kjo rrethanë flet në mënyrë të veçantë kundra një burimi të *zgjoi-t* prej lat. *\*excavone* ose *\*excovo-*.

*zi* f., *i zi*, fem. e *zezë*, shm. të *zez*, të *zeza*. Fjalë me burim të diskutuar. G. Meyeri në Fj. et. nuk shprehet; më vonë (AS IV 43) e afron — me rezervë — me lit. *žilas* «i thinjur» let. *zils* «i rimtë». Jokli (Studien 100 vv., LKU 27, IJ XXII VII 169 (vren — edhe kundra Mjedës — se mbi dëshminë e mashk. shm. të *zez*, *-zë* te fem. e *zezë* është pjesë e temës, jo sufiksi deminutiv *-zë*. Ai vetë e vendon fjalën e shqipes te grupi lit. *gedū* «mbaj zi» *gēda* «turp, mbarë», prus. vj. *gidan* «turp», rus. *gadkij* «i ndyrë, i ndjetë, që të vështiret» *gažu gaditš* «ndy, ndrag, prish», gjerm. *Kot* «ndyresë, të pëgërë» etj.; fem. *zezë* sipas tij nga një bazë *\*guedhiā*, shm. mashk. të *zez* nga një *\*guedhiōi*, *zī-a* nga një *\*zē-i* e kjo nga *\*guedhijā*. Etimologji e kundërshtuar te Thumbi Gött. Gel. Anzeigen 1915 f. 24,26 (sh. dhe Walde-Pokornyn I 696), po pranuar te Tagliavini 293 e te Pokorny I 485. Përsëritur kohët e fundit fjalë për fjalë të Bariçi (Godišnjak I 253 vv.), pa zënë ngoje aspak emrin e Joklit. Krej fantastik krahasimi me bask. *itzaso* «det» e me arm. *tsow* «det» nga ana e J. Karstit (Alarodiens et Proto-Basques 1928, f. 82v.), sh. vrejttjet e Joklit IJ XIV VII 149.

E mbarë gjuhës. Buzuku (XLVII/2, Ester 13,17) *e kthe zinë tanë ndë gazëmend* «et converte luctum nostrum in gaudium». Budi (RR 341) *jashtë ziet e vobëziet, e vajt e nëkimit*; Bardhi Mare nigrum *Dëtë i zī*, Niger I *zī*, Nigellus I *zīth*, Nigredo Të *nximitë*, Nigrefacere *Me e nxīm*, Nigrescere *Me u nxīm*, Nigresco vestes *Nxīnj petëkatë*, Obniger *Fort i zī*, Penuria *Zia*. I mbarë gjuhës dhe mbiemri *i zeshk*, e *zeshkë*: Buzuku (XIIb) *Jam e zëshkë, ma jam bukurë formuom* «Nigra sum, sed formosa». Bogdani (II 7, 8) *e zëshkë* «di colore bruno», në Greqi *bukë e zeshkë* (Reinhold, Glosari 32). Për të tjerat rrjedhoja të fjalës, si ndër të tjera *zeshkël* «lopë e zezë», *zik* «ka i zi», *zezonë* «rrenim i madh, hallë *zezelinë* «vend hie», *zijosh* «zeshkan, esmer», *zishëm* «në zi», e *përzi-tur* «që është në zi», *i nxiri* «i ndjeri», foljet *nxirōj* figurshëm «vras»,

*zitoj* «nxi», sh. vrejttjet tona BSS 1952 Nr. 3 f. 42 vv., z. f. Phon, u. allg. Sprachwiss. 9, 209 vv. Për kuptimin «i mjerë, fatkeq» khs. e të *zitë taj kā me ū kthyem ndë gazëmend* «sed tristitia vestra vērtetur in gaudium» (Buzuku LXVII/2 = LXXVII/2, Gjoni 16,20), proverbin *parja e bardhë për ditë të zezë*, për gjuhët ballkanike khs. P. Papahagium XIV. Jahresber. d. Rum. Inst. Leipzig 154. Një emër burri *Gjergj Zeza* përmendet në Katastën e Shkodrës 1416-17 (Leka XV 174); *Spiridon Zeze* edhe tek aromunët (Capidan DR I 491, 553). *Zeza* edhe emër lumi e emër vendi, *Mëzezi* katund afër Tiranës. Nga *me zi* ka dalë ndajfolja *mezi*, nëpër dialekte edhe *memzi*.

Morfologjikisht mbiemri *i zi* mund të ketë dalë nga adjektivimi i emrit *zi-a*, më fort nëpërmes të një përdorimi predikativ, duke kaluar p.sh. *është zi* gramatikisht e semantikisht në *është i zi*, khs. përdorime të tilla si *të je rini* për «ti je i ri». Etimologjitë e gjertanishme të fjalës nuk qëndrojnë. Afrimi me lit. *žilas* let. *zils*, sikundër vren edhe Jokli, ndesh në vështirësi morfologjike, në rrethanën që *-zë* te *e zezë* është e temës. Krahasimi me lit. *geda*, rus. *gadkij*, gjerm. *Kot* «ndyrësi»; baltë» etj. nuk është afër menç për arsye kuptimore, sepse ky grup fjalësh përmban idenë e ndyrësisë e të së ndohtës. Si e kemi shtjelluar dhe në viset e cituara, *zi-a*, *i zi*, e *zezë* është një nga ato fjalë të shqipes, në të cilat *z*-ja nistore buron prej një *j*-je (*i-je*) indoeuropiane. Si e tillë kjo fjalë krahasohet me lit. *jūodas* «i zi» (kjo nga një bazë *\*iōdas*), let. *juōds* «një demon i pyjeve, një hie e ligë». Fjalën baltike Pedersen (St. baltici III 69 v.) e afron me irl. *adaig* «natë» dhe eventualisht edhe me lat. *āter* «i zi, i errët, i zymtë», po për këtë të fundit ka të tjera spjegime, sh. Walde-Hofmannin I 75 v., Fraenkelin I 197. Forma bazë e *zi-së* (e me të bashkë dhe e mbiemrit *i zi*) është *\*jōdiū* (*\*iōdiū*), e *zezë-s* *\*jōdiā* (*\*iōdiā*), e shm. të *zez* *\*jōdi* (*\*iōdi*). Me *zezë* mbase barazohet edhe emri fem. ilir. *Jadia*, në një mbishkrim të Salonës *Titiae Jadiae*, një emër i krahasueshëm me it. *Bruna*. Georgievi m'anë tjetër (Tra-kijskiat ezik 61) me emrin *Zeza* krahason emrat vetiake të trakasve Ζεζαs, Ζεζιs *Sezus* etj. — Sh. dhe i *zymtë*.

**ziej.** Këtë fjalë G. Meyeri (f. 485, AS IV 30, V 106) e bie të ardhur prej gr. së re ζέω «ziej, valoj». Etimologji e pranuar te Jokli (IF 49, 294, Slavia XIII 316) e te Tagliavini 294, me gjithë se i pari nga këta dy dijetarë shtron disa kërkesa në lidhje me kronologjinë.

Fjalë e mbarë gjuhës. Buzuku (LVIII = LXVIII, Eksodi 12,9) *E atë mos e ani pjekunë keq, e as grimëzë n si zienë me ujë* «Non comedetis ex eo crudum quid, nec coctum aqua». Bardhi *Miscere Me përziem*, Mistus *Përziem*, *Miscellanea Të përzieme*. Në Sofikó të Korintit (Greqi) të përziemi me të mirë «u pjekshim me të mira», te V-ariboba (cituar te Giordano) *u përzietim të di na bashkë* «ci siamo uniti noi due insieme», në Siqeli (Hora e t'Arbëreshvet) *përzi-t-a* f. «marrëdhënie, comunanza», *me tëndin xā e pi, me të xojin mos kesh përzi-t*. — Si e kemi shtjelluar edhe gjatë (BSS 1952 Nr. 3 f. 50 v., Z. f. Phon, u. allg. Sprachniss. 9, 219 vv.), huazime greke të tilla si *qendis qeverris*, si e vuri re sëpari Miklosichi (AF III 31 vv.), tregojnë se burimi i tyre është tema e aoristit të greqishtes; prandaj edhe ζέω ἔζεσα do të kish dhënë në shqipen një *\*zes*, jo *ziej*. Në këto rrethana shihet se *ziej* është fjalë vendi, e afër me fjalën greke. Si në disa të tjera fjalë, edhe këtu *z*-ja nistore ka dalë prej një *j*-je (*i-je*) indoeuropiane. Duke buruar nga një bazë *\*jesniō*, (*\*iesniō*), kjo hyn në grupin ind. e vj. *yāsati* «vrijon,

zien», gr. ζέω, kymr. *ias* «fervor, ebollutio», gjerm. e lartë e vj. *jesan* «me vlue, me shkumdet» etj. Do shënuar ndërkaq që ky afrim me fjalët inde e greke gjindet që te Kamarda (I 89), e më vonë, bashkë me rregullën fonetike *j:z*, edhe te Manni (Lg 28,38), pranuar dhe te Frisku I 612. Baza e Mannit \**ieseiō* për ne është më pak afër menç se e jona \**iesniō*. Te ky grup fjalësh A. Mayeri (I 162, II 52, më parë në Vjesnik Hrv. Arheol. Dr. n. s. XVI 69 vv., sh. IJ XXI VII 133) vendon edhe *Aquas Jasas*, emrin ilir të banjave me sqfur *Varaždinske Toplice* në Kroacinë e sotme. Het. *zeia* «zijej», shënuar te Friedrich 260, mund të hyjë edhe kjo në këtë grup fjalësh.

**zis zit** «nxit». Për këtë fjalë të geg. veriore (Junku *t'zitun* «provoca, aizzamento», i *zitun* «provocato, aizzato») G. Meyeri, 485 mendon — me dyshim — një burim prej sllavishtes, serbokr. *zatka* «provokim», prej *zataci* «me vu, me varë». Selishçevi s'e numëron ndër elementet sllave të shqipes.

Sikurse e kemi shtjelluar më lart (te *cys* e te *nxis*), kjo fjalë hyn në një grup leksik të shqipes, ku bëjnë pjesë ndër të tjera *cys cyta* «ngas, ngacmoj, shtyj», *nxis nxit* me *nxitoj nxitim*, *gëcit* «tundoj», *guxit guzit* «ngas, gërgas», *gacit*, *gaxhis*, *gëzhit gëzhas*. Disa nga fjalët e këtij grupi paraqiten me *-i-* (*zis zit*, *nxis nxit nxitoj*, *gaxhis*, *gëcit*, *guxit guzis*, *gacit*), ndonjë me *-y-* (*cys cyt*), e ndonjë me *-u-* (*cus cut*). Raporti fonetik i këtyre trajtave në mes të tyre mbetet i paqartë. Vetëm mund të themi se trajtat me *-s-* si *cys zis* kanë dalë prej trajtash me *-t-*, me *s* nga *tj*. E qartë është gjithashtu se *nxis nxit* është një kompozit i *zis zit* me *n-*, pra nga *n-zis n-zit*, me fortim të spirantit në një afrikatë; khs. *zi: nxij*. Mendimi i Mannit (Lg 28, 36) që *zit nxit* ka të bëjë me lit. *gyvatà* «jetë, banesë», lat. *vita* «jetë» etj., baza e fjalës së shqipes një indoeur. \**gūiuotā*, përveç së tjerave nuk qëndron dhe për arsye të kuptimit.

**zmojle** f. «djerr, qersë». Sipas Joklit (BA IV 196vv.) prej një lat. vulgare \**exmulgia*, postverbal i *e(x)mulgeo* «mjel gjer në fund, shter, thaj» *zmojle* me epentezë nga \**smoliĭa* \**zmoliĭa*, për kuptimin khs. rum. *zmulge* «shkul», it. *smungere* «me thithë, me përtha». Etimologji e pranuar te Meyer-Lübke REW 2864.

Si e kemi shënuar dhe në Revue de Ling. VII 1 164vv., ndrimi *u:o* që vihet re këtu, si edhe në toponimet *Groftat e Gojanit*, *Shkortull* e *Maja Volpul*, nuk rrjedh (me Joklin) prej latinitetit të Prevalitanës, po është një zhvillim i brendshëm: ndrim fonetik i geg. (veri) lindore, i cili arrin gjer në geg. veriperëndimore e në brigjet e Adriatikut.

**zog** m. Këtë fjalë G. Meyeri te Fj. et. 486 e la pa spjegim etimologjik, po më vonë (AS III 18) e afron me arm. *jag* «zog i ri, zokth», pers. e re *zâq* «i vogli i shtazës» dhe eventualisht edhe me ind. e vj. *jahu* «i vogli i shtazës», baza e *zog-ut* sipas tij një \**g'hāgos*. Etimologji e miratuar te Pedersen KZ 36.338, Walde-Pokorny I 531, Pokorny I 409, khs. dhe Tagliavinin 294v., Mannin Lg 28, 36, Cimochowskin LP II 232.

Fjalë e mbarë gjuhës. Si emër familjeje *Zogi* del në Ulqin e Tivar më 1380, si ofiq (shkruar Çogho) në Drisht në vitet 1399-1404. Jireček Die Romanen in den Städten Dalmatiens I 77, Šufflay Städte u. Burgen Albaniens 37 shën. 15. Për hetimin e gurrës së saj do pasur parasysh se kuptimi i mirrëfilltë i saj është jo vetëm «i vogli i shtazës» (G.

Meyer), po mund të shkohet dhe më tej e të thuhet që ai kuptim është «i vogli, i riu». Khs. prej Buzukut (LXXXIV/2 = LXXXIV/2, Luka 2, 24) *një par turtuj o dy zogj n pëllumbash* «par turturum, aut duos pullos columbarum», prej Bogdanit (II 87, 11) *qi prej gjytetje, t i bijinë Gomarenë, me zog të sajnaj* «acciò dalla Città li menassero l'Asina col polledro». Edhe sot në geg. veriore *zog pele, zog gomari* (edhe figurshëm), *zog thiu, zog dreqit, Mos po është harusha me zoq?*, *Si zog krajlit, S'ishte zog nanet qi mund i delte përball, Djepin në shpin, zogun në krah* me kuptimin e foshnjës. Në një këngë Kosove *Stalle Dena zog drangue*, Elezović Arhiv II 257. Në gjuhën e gjahtarëve të Tiranës *zogj janë shpestë e vegjël, shpend të mëdhenjtë* (R. Dema), sh. edhe Weigandin BA I 263, ER prill 1931 f. 117, dhe Kurtin (Prralla kombtare II<sup>1</sup> 131) *Thrret të gjith shpendt e mdhaj dër në zoqt më të vogjëlt*. Në Malsi të Madhe *zogçe* «zogu i gomares, kërric, polisht» (Shkurtaj). Në një këngë të Krajës *mos u trem o zog bugari*, në një të Shemrisë afër Tiranës *Mre Lëmaz, zogu i Lik Drishës*. Në tosk. jugore (Gjirokastra) thonë *ti je zogë* «ti je e re», *ti je zog* «je i ri». Khs. dhe *mjaltë zogash* «mjaltë bletësh të reja». Kuptimi i fjalës ka shkuar nga «i ri» në «i vogli i shtazës», pastaj në «zog i ri, zokth», më tej në «zog i vogël» e «zog» përgjithësisht, sh. vrejttjet tona BSS 1952 Nr. 3 f. 49v., Z. f. Phon. u. allg. Sprachwiss. 9, 217v. Në këto rrethana, *zog*, refleksi i një baze \**jëguo-* (\**ieguo-*) «i ri», është fjalë e afër me gr. ἴβη «fuqi e të riut, moshë e fuqisë, djalëri» ἴβᾶω «jam në fuqi të djalërisë» ἴβᾶρω «piqem, bëhem burrë» ἔβηδος ἔφ-ηβος «djalë i rritur», të cilën e afrojnë me lit. *jegà, pajegà* «fuqi» *jegù jëgti* «kam fuqi të, jam i fortë», let. *jëga* «fuqi fizike, mendje, kuptim» *jëgt* «me kuptue». Në qoftë se *zog* m'anë tjetër afrohet — si mendon G. Meyeri — me arm. *jag*. (shqiptuar *dzag*) e pers. e re *zâq*, atëhere kemi përpara nesh një barazim mjaft të hapët, me një përhapje «indoeuropiane dialektore» në vështrimin e Meillet'së.

**zogorí** f. «llavë ujqsh, derrash të egër a qensh». Mungon te G. Meyeri, me gjithë se gjindet dhe te Bardhi, po me një tjetër trajtë, Cohors *Shogëria*. Kristoforidhi e jep për të folët e Elbasanit, si *zagorí* «tufë derrash të egër, ujqsh, qensh etj., metaforikisht edhe për njerëz». Mbi dëshminë e kësaj trajte Weigandi 102 e lidh me *zagar*.

Del që te Budi (DC 204 b, SC 204, 255): *Ë si një zogorí Gjithë uqshi cë tërbuom; posikūr ndōnjë kīngj ò delezë e vetēmeja ndē mjedīstē zogorīsē uqet e të kulçēdravet; e se embërrinē mb atē ças e e mpshinē për gjithē anēshit, posikūr zogoria e uqet një dele të vetēmenē*. Bogdani *sogērī sogorī sogarī*, si (II 98, 2; 99, 5; 101, 8; 102, 11) e ajo *sogērī Xhudhīsh* «e quella mandra di Giudei», *tue u avitunē asaj sogorī Xhudhīsh* «accostandosi a quella turba de Giudei», *Embërrinī ajo sogorī nierēzish çpejt ndē Gjytet të Jerusalemīt* «Pervennero quei manigoldi con fretta grande nella Città di Gierusalemme», *ajo sogarī xhelatash* «quella turba di sbirri». Nga fjalorët, *Bashkimi ka zagorí zogorí zogarí* «branco di lupi, banda di malfattori». Leka IV 78 *Porsi ujqt, qi. . . Zogorī dīrgjen nīherit*. — Është një rrjedhojë e *zog*-ut me domethënie «i ri» që u shtjellua më sipër, te *zog*. Kuptimi i parë «tufë zogjsh të ujqve, të derrave të egër etj.» Khs. përdorimin e *trimēnī-sē* (nga *trim* që do të thotë dhe «djalë i ri») si një sinonim të *zogorī-sē* te Budi (DC 217a), *Xhudhītē u mbēlodhnē, Me një tufē trimēnī*. Për zhvillimin e kuptimit khs. dhe angl. *covey* «zogjtë e kllōckës, tufë zogjsh; zogori, bandë e keqe». Morfologjikisht *zogarī* është një zgjerim i *zog*-ut me sufiks *-arī*,

i cili paraqet zgjerimin e *-ar-it* me *-i* dhe formon emra përmbledhës (kolektivë), si *bujarí*, *katundarí*, me ndrim *a:ë ushtëri*: *ushtár*, sh. për këto Xhuvani-Çabej Prapashtesat 20. Te *zogori* ka asimilim progresiv të zanoreve, te *soqëri* reduktim *a:ë* si në *ushtëri*.

**zulmë** f. «lavdi, famë». Këtë fjalë të arbërishtes së Italisë G. Meyeri 487 e jep pas De Radës si *zul'ë* «britmë» *zul'inj* «bërtas», dhe e bashkon me *zurrnë*, *xhurá*, *cule*, të cilat i bie të ardhura të gjitha prej turq. *zurna* «lloj surle, zamare». Xhuvani (Kop. letrar I Nr. 1 f.6) e jep pas G. Darës (Kënga e sprasme e Balës 24,26, 60) si *zulmë* «rino-manza, gloria» dhe e spiegon nga *zâ lum* «zâ i lumë», e cila nëpër *zëlum*, *zlum* arriti me metatezë në *zulmë*. Manni (Lg 28,38) gjen aty një fjalë vendi të lashtë, e cila, si refleksi i një tipi \**ieulis*, afrohet me gr. e vj. *ῥουλος* «këngë për nder të hyjnisë Demetra».

Asnjë nga këto spiegame nuk bind. Fjala arbëreshe është tepër e largët nga reflekset e turq. *zurna* në gjuhën shqipe, si nga forma si nga kuptimi, sh. më lart *xhurá*; përveç asaj është fort e dyshimtë që fjala turke të ketë depërtuar para shpërnguljes shqiptare për në Itali. Një burim nga *zâ lum* është morfologjikisht i pamundur. Krahasimi me gr. *ῥουλος* nuk mund të mbahet, sepse — përveç së tjerave — kuptimi i parë i fjalës greke është «push i parë, dyaj drithi, gath». Përgjithësisht një fjalë me ekzistencë të dyshimtë. Ndeshet vetëm te shkrimtarët arbëreshë, jo në ligjërimin popullor, sh. dëshmitet te Giordano.

**zvugullón**: sh. *vagëllój*

**zxhollë** f.: sh. *gëzhojë*

**zymtë** (i) «i vrerët në fytyrë, i ngryset; i trishtuar, melankolik»; *zymtój* «e bëj të zymtë», *zymtohem* «bëhem i zymtë»; *zymnéj* «trishtoj, brengos» *zymnehem* «trishtohem, brengosem», *zymnim* m. Mungon te G. Meyeri, me gjithë se del që te Bardhi: *Maestus mesto Zymënë*, *Mae-rëre Me u zymënyem*, *Tristitia Zymënim*, *mallëngjim*, *Tristare Me u zymënyem*. Bashkimi i *zymtë* «mesto» *t'zymtë* «mestizia» me *zymnye* «contristare, affliggere» *zymnim* «tristezza, malinconia, mestizia». Sikundër e kemi shënuar në BSS 1952 Nr.3 f. 43, Z. f. Phon. u. allg. Sprachwiss. 9, 210, është një me *zi*, *i zi*, me labializim të *i-së* në *y* në afërsi të konsonantit labial. Këtë e vërtetojnë disa forma të gegërishtes që paraqiten me *-i-* e vise-vise edhe me kuptimin konkret të ngjyrës së zezë: *Mafsheqi i Krujës Ç'ke Hasime qi rri zim?*, te Ura Shtrejtë pranë Postripës *T'kujt në faqe, t'zimt në sÿ* (Q. Haxhihasani). Morfologjikisht nga *zi*, *i zi* sëpari u formua *zim* *zÿm*, me sufiks *-m*, i cili shpreh nganjëherë kuptimin e gjasisë e t'afërimit: *i përhimë*, *i bardhemë*, në emra *vëllám*, *mótërmë*, *veme*, sh. LP VIII 108 shën. 75, ShS 128 shën. 206, Xhuvani-Çabej Prapashtesat 69. Këtij formimi erdhi e iu shtua *-të-ja* mbi-emërore, si te *i largët*: *i largë*, *i pakët*: *i pakë*, *i shumtë*: *i shumë*, sh. për këtë BSS 1955 Nr. 4 f. 119vv. Kështu u sajua *i zymtë*. Nga foljet, *zymnéj*, *me u zymnyem* ka dalë nga *zim zÿm*, *zymtoj* nga *zymtë*.

**zhagít** «heq rrëshqanë», *zhagitem* «hiqem zvarë». Për këtë fjalë G. Meyeri 398 përveç kësaj forme jep dhe *shagit*, *saqit* e *zxhagit*, po e lë pa spiegem etimologjik. Duke u nisur nga *shagit*, Bariçi 97 e afron përbrenda gjuhës dhe me *shes* dhe me *shëlligë*, afrime që nuk qëndrojnë as nga ana e fonetikës, as nga e kuptimit.

Fjalë e geg. veriore. Nga një krahasim i formave të saj shihet se ajo më e përdorura ndër to është *zhagitem*. Kjo del dhe te Junku si *me zhagit* «strascinare», te Logoreci «me ngrehë rrshanë», te Bashkimi me *zhagmitë* e me *zhagmue* «strascinare opprimendo». Folja me të gjitha trajtat e saj ka dalë nga ndajfolja *zhag* «rrëshqanë, a strascioni» (Junk), te Bashkimi *zhag* «strascioni» *zhagas* «a strascioni, stentamente», te Logoreci *me ngrehë zhag* «me ngrehë rrshanë». Me këtë folje është sigurisht identike dhe *m'u zhagitë* «me i ra të fikët, svenire» e Bashkimit, te FGS të *zhagitunit* «të fikëtit, vilania», te Kordinjano *m'u zagjitë, i ra të zagjitun*. Fjala *zhag*, nga e cila u zhvillua dhe *zhagitem*, është një në thelb me *zharg* «rrëshqanë, zvarë» (*e hoq zharg*), të cilën edhe Gazulli e jep për Malsi të Madhe krahas me *zhag* e me *zhagas*. Prej *zharg* është formuar *zhargoj* «heq rrëshqanë, heq zvarrë», poashtu si *zhagitem* prej *zhag*-ut. Te *zhag zhagas zhagit* etj. përkundrejt *zharg*-ut vihet re zhdukja e *r*-së përpara guturalit velar, poashtu si te *ag agon agim*, sh. *ag*. Morfologjikisht *zharg* është adverbializimi i emrit *zharg* «lëkura që ndërron gjarpëri në prandverë; lëkura që vesh arkën e lahutës përsipër; lëkura e drurit». Ky emër paraqitet dhe si një fem. *zhargë* me kuptimet «lëvore» e «këpucë e grisun, e shkyeme, shkarpë», të cilën Gazulli e jep për vise të ndryshme si dy fjalë të ndryshme, Bashkimi si «trasandato nelle vesti e nel portamento», Junku si i *zharg* «tra-sandato», Logoreci si i *zhargët* «i shkatrruem në veshë e në mbathë». Kuptimi që jep Manni për *zhargë-n*, «jargë e kërmillit», pas mendimit tonë u ka përfutur nga një kryqëzim i *zharg* «lëkurë, lëvore» me *jargë*, me anë të një etimologjie popullore. Burimi i *zharg*-ut e *zhargë-s* e i gjithë fjalëve që kanë dalë prej sosh (*zharg* me *zhargoj*, *zhagitem* me variantet e saj etj.) do kërkuar te *shark* L., kuptimi i parë i së cilës është «lëkurë», sh. atë fjalë. Trajta *shagit shagitem* e Rossit, nga e cila nisen G. Meyeri me Bariçin, mund të ketë dalë drejtpërdrejt prej *shark*-ut, pa varësisht nga *zhagitem* që është një denominativ i *zhag*-ut. Në shqipen vihet re sonorizimi i një *sh*-je nistore në disa rasa, si *zhyt; zhytem, shakëmis; zhakminj, shark; zharg zhag* që u pa këtu, e ndonjë tjetër. Po te *zharg* përkundrejt *shark*-ut shihet dhe një sonorizim i konsonantit fundor. Edhe ky vihet re te *shark*-u, për të cilin ka dhe një variante, *sharg*. — Sh. edhe *zhangë zhangël, zharg*.

**zhangë** f. «zhapë, lapër», *zhangël* f. «zhangë, zhapë, lapër». Fjalë e geg. veriore, që mungon te G. Meyeri. Del sëpari te Junku, si *zhangël* f., shm. *zhangla* «rimasugli di carne fritta inutili», te Bashkimi *zhangël* e *zhangër* «rimasugli di carne e grasso, fritti inutili», te Gazulli *zhangël* «pjesë e trupit të frymorvet qi langon», po me kuptime anatomike të errëta. Primitivi *zhangë* te FGS. Prej si janë formuar *zhangël* e *zhangër*, si diminutive me *-ël* (*-lë, -l*) e *-ër*, formante, për të cilat sh. Xhuvani-Çabej Prapashtesat 65v, e 41. Etimologjikisht kjo fjalë lidhet me *zhag* «rrëshqanë», e cila buron prej *zharg* «lëkura që ndërron gjarpëri në prandverë; lëkura që vesh arkën e lahutës përsipër; lëkura e drurit», *zhargë* «lëvore; këpucë e grisun, e shkyeme, shkarpë». Kështu pra *zhangë zhangël zhangër* në thelb do të thotë «lëkurë, lëkurë që varet». Sh. për *zhag* te *zhagit*. Te *zhangë zhangël* kemi një epentezë «popullore» të *n*-së, si te *çomangë, mungull* etj., sh. vrejttjet tona BSS 1953 Nr. 4 f.35.

**zharg** m. «lëkura që ndron gjarpëri në prandverë; lëkura që vesh arkën e lahutës nga sipër; lëkura e drurit»; e *hoq zharg* «e hoqi zvarë,

rrëshqanë». Mungon te G. Meyeri. E ka Bashkimi si *zharg* m. e *zhargë* f. «pelle che è deposta dal serpente in primavera, scorza d'albero»; Gazulli *zhargë* «lëvore», *zhargë shelqe*. Një trajtë *zherku* e jep Nopca (f. 118), si «lëkurë shtaze që shërben si arkë resonance e lahutës» me një -e- të hapët që ka shpeshherë geg. veriperëndimore në vend të a-së. Sikurse e kemi shtjelluar në LP VII 178vv., ShS 50v., *zharg* paraqet sonorizimin e shpeshhtë të sibilantit *sh* në ballë të fjalës (khs. *shur zhur* nga lat. *saburra*) e bashkë me këtë dhe të guturalit fundor. Kështu është identike me *sharku* i bollës «këmishë e gjarpërit», *shark* «bërruc», *sharkë* f. «mantel prej leshi të bardhë, flokatë», sh. këto fjalë. Të gjitha burojnë prej një fjale të vetme, kuptimi i parë i së cilës është «lëkurë». Me këtë afrohen më tej *shakull*, *rrëshék*, *rrëshiq*, *shirk* e disa të tjera. Veçanërisht me *zharg* lidhet dhe *zhargë* f. «këpucë e grisun dhe e shkyeme, shkarpë» që jep Gazulli për Malsi të Madhe. Lidhja kuptimore e ndajfoljes *zharg* «rrëshqanë, zvarë» me emrin *zharg* është afërsisht ajo që shihet dhe te *mbeti shakull* «ra përdhe pa frymë» ndaj emrit *shakull*. Kjo ndajfolje te Junku, Bashkimi, Gazulli e gjetkë paraqitet, me rënie të —r—së para guturalit, si *zhag*, *zhagas*, te Gazulli me *ngrehë zhag*. Andej dhe foljet *me zhagitë* e *me zhagmitë* «me hekë rrëshqanë» te Junku e te Bashkimi, te Kordinjano *me zhagmue*. I ra të *zhagitun* ka marrë kuptimin «i ra të fikët».

**zhdo** «disa». Kjo fjalë te Buzuku paraqitet e shkruar me atë germë e që vlen dhe për *z* dhe për *zh*, p.sh. (LXII/2. Gjoni 12, 20) *E zhdo Griq qi ishnë ardhunë m Jeruzalem me u lutunë mbë festët...* «Erant autem gentiles quidam ex his qui ascenderant ut adorarent in die festo». Ky lexim përligjet me një dëshmi shumëfishe: *shdo zhdo* te Boçari (f. 54, 68), *zhdo* pranë *çdo* në të folët e Krasniqes (M. Gecaj), *dizhdó* «disa» në Borgo Erizzo. Tagliavini (f. 105) këtë e zbërthen në *di-zh-do*: *di* «unë di», *zh* = *sh* «mbeturinë e një elementi përemëror si te *kush*», edhe *do* «ai do». Më e drejtë është analiza e Joklit (Archivum Romanicum XXIV 23): *dizhdo* = *di-çdo*, ku *çdo* «secili, secila», khs. *çdokush* «ὄστις δήποτε» te Kristoforidhi.

Me të dhënat e Buzukut e me të tjerat më sipër kompoziti *dizhdo* zë vendin që i përket brenda strukturës morfologjike të shqipes. Baza e fjalës, si e vuri re edhe Jokli, është *çdo*. Vecse këtu kjo fjalë është përdorur jo me kuptimin «secili, secila», po me atë të «disa». Kështu e ka të folët arbërisht të Horës së Arbëreshvet (Piana) në Siqeli, ku e shqip-tojnë *çdô*; ashtu e përdor dhe G. Kamarda te Ungjilli i Mateut f. 28. Ndrimi i *çdo* në *zhdo*, si e vuri edhe Jokli, është thjesht fonetik. Ai në të folët e Gjirokastrës vihet re dhe te përemri *çdo* «secili, secila» e te fjalia pyetëse *çdo*, të cilat shqiptohen *zhdo*, *zh do*. Me *çdo zhdo* kanë lidhje edhe përemrat *xhokúsh* «dikush» *xhoç* «diç» dhe ndajfolja *xhokú* «diku» po të këtij dialekti, në të cilat *xh-*, fonetikiisht tingull i përbërë *dzh-*, ka dalë nga *zhd* (si te *zhdo*) me anë metateze. Hahni (Gramatika 59) për *xhokúsh* jep trajtën *çokúsh*, e pranë kësaj dhe varianten më mirë të ruajtur *zhðokúsh*. Pedersen (f. 200 v.) për *çokú* «diku» e *çoç* «diç» pa të drejtë mendon se përmabajnë urdhëroren e foljes *çoj*. Ato piqen me *xhokú xhoç* të Gjirokastrës dhe reflektojnë, bashkë me këto, trajta më primare me *zhd-* e më tej me *çd-*. Ndrimi *ç-*: *zh-* para konsonanteve të zëshme vihet re ndërkaq dhe te folja *çkul*: *shkul*: *zhgul*, *shkriej*: *zhgrryej*, *çbëj*: *zhbâj* etj.

**zhdrivillôj** «zbledh, shkatërroj një lëmsh a një tjetër gjë të ngatërruar: shprish, shkrijoj flokët; spiegoj, shtjelloj një mësim a një temë; zhvilloj». G. Meyeri 488 e jep (për shkodrnishten) me kuptimin «zgjedh» dhe e bie të ardhur prej skr. *ždrijeb* «zar, shorte» *ždrebatì* «shtie në shorte», Ashtu dhe Selišcevi 182, 196. Përkundrejt këtyre, Jokli (Slavia XIII 318) vë në vend kuptimin e vërtetë të fjalës, ekzistencën edhe të *zhvilloj* pranë *zhdrivilloj*, dhe mbi dëshminë e *zhdërvjellët* «i shkathët, i shkrythët, i shpërdhitë», *zhdrivilloj* e zbërthen në *sh-(zh)-ter-vjell*. Këtë, si një fjalë vendi, e bie të ardhur prej bazës indeour. \**vel-* «rrotulloj, sjell, përdredh, rrokullej», ku sipas tij hyjnë shq. *vjel, vjell*, lat. *volvo* «sjell, rrotulloj, rrokullej» etj. Edhe pas këtij spjegimi të drejtë Skoku (Jugosl. Encikl. I 162) i mbahet mendimit të gurrës sllave. Bariçi (Godišnjak I 260) përsërit fjalë për fjalë shpiegimin e Joklit, pa cituar autorin.

Kuptimi i gabuar «zgjedh» që jep G. Meyeri do të ketë rrjedhur nga kjo që ai it. *sciogliere* «zgjidh, zbledh» të Rossit e ka marrë për *scegliere* «zgjedh».

**zherk** m.: sh. *zharg*.

**zhyej, zhyj** «ndyj, zhgryej», *zhyhem* «ndyhem, zhgryhem», *çuni u zhye në baltë*. Pa spjegim etimologjik te G. Meyeri 489. I pambrojtshëm bashkimi me *shkrikenj zhgryej* te Kamarda I 89. Në thelb asnjë spjegim te Treimeri MRIW I 365, Slavia III 452.

Del që te Budi (DC 180 a. 194 a, SC 12), *Gjithë zhyem e pëgâm; gjithëherë zhyem e pëgâm; e pshtuellë e ngatërruom me gjithë duorshi cë mpkatevet*. Ideja e të ndyrit ka dalë shpeshherë nga ajo e të kredhurit në ujë a në një baltinë. Prandaj *zhyej zhyj* nuk është veçse një formë e *zhys zhytem*, me kalim analogjik të kësaj folje në klasën e foljeve (nazale) më *-nj -j*.

**zhys** «kredh në ujë», *zhytem* «kridhem në ujë», *zhytë në borxhe* «mbytur në borxhe». Mbetur pa etimologji te G. Meyeri 489, i cili e jep me format *zhys shys e zhytem*. Bariçi I 124 e shpie te një bazë indoeuropiane \**sm + gneptos esmi* «jam zhytur» dhe atë \**gneptos* e afron me gr. *βάπτω* «zhys, ngjyey», nord. e vj. *kvefja* «zhytema, fundos». M. E. Schmidt (KZ 50, 246v.) zbërthen *zhys shys* në *sh-ys*, dhe afron pjesën tematike me *ujë*, duke e çuar atë te një formë bazë \**ūdīō*.

Fjalë e gegërishtes, më fort e anës veriore. Aty hyn dhe *zhyt në bie zhyt* «bie i tëri në ujë», *zhytas* «zhyt», dhe emrat zoologjike *zhytër* f. «*Colymbus ruficollis*; *Podiceps auritus*», të dy shpend notarakë, *zhyt-kryekuqe* f. «*Podiceps auritus*», *zhytarák* m. «*Nyroca ferina*, rosë e egër e zezë», me të njëjtin sufiks si *kredharak, notarak*. Te Bashkimi edhe *zhytryej* «njolloj». Për historinë e fjalës peshon kjo, që *zh-ja*, sidomos ni-storja, në fushën dialektore ka dalë nganjëherë prej *sh-së*, si te e *mazhër, zhapì, zharg, zhur*. Edhe këtu fjala ka nisur mirëfillit me *sh-*. Kështu Bogdani (I 142, 1) ka *Mpkatetë ndë të siat ishinë shytunë* «I peccati, nei quali erano immersi». Gjithashtu në Pejë thonë *shytem* për «zhytem», dhe te Junku emri i zhytrës është *shytër* «piccola folaga». Prandaj *zhyt* është një me *shyt*, në *ra shyt përdhë* «ra thes përdhe». Khs dhe *mbeti puna shyt: mbeti puna zhyt, kryeshyt: kryezhyt* «kryengulthi». Kjo *zhyt* është identike me *shyt shut* «pa bri; që ka humbur majën e s'pret mirë». Kështu edhe *zhyej*, e cila s'është tjetër veçse *zhys*, te Godini 53 (*be-flecken* «njolloj) jepet si *shyey*.

## R E S U M E

## ETUDES D'ETYMOLOGIE ALBANAISE XXVIII

Note. Le son x (dz), lorsqu'il n'apparaît en des emprunts faits à d'autres langues, ne représente pas un ancien phonème de la langue. Il résulte d'ordinaire de l'affrication de la spirante z, ou de la sonorisation de c (ts), ou de l'assimilation du groupe dz, ou bien de la métathèse de zd, phénomènes qu'on rencontre dans diverses langues. Souvent on a à faire à des formes onomatopéiques. — Des noms commençant par un xh — (dž-), la plupart sont d'origine étrangère. Quelque fois dans les parlers du Nord, il s'agit du reflet d'un gj.

**xa** «voici» Il s'agit d'une forme verbale, l'impératif de zë «saisir», employé comme adverbe. Cfr. à ce propos xani «voici», lorsqu'on s'adresse à plusieurs personnes.

**xamare** f.: v. zamare.

**xandë** f.:v. xanxë.

**xanë** f.: v. xanxë.

**xanxë** f.: «mauvaise habitude», xandë même sens, adj. xanxâr, fem.

**xanxare** «récalcitrant» (d'un mulet, dit aussi des hommes), en albanais d'Italie canxanis «tenter», tous mots restés inexplicés dans G. Meyer, p. 79, 439. Le même mot que neo-gr. ζάντισα «manière particulière; originalité; caprice, bizarrerie» et arom. dzandzâ «caractère, tempérament grincheux, nervosité, fâcherie; emportement». A ranger ici peut-être encore xanë «genêt».

**xarbë** f.: v. carbë.

**xehë** f. «puits de mine, minière». Comme l'a bien vu G. Meyer, de l'all. Zeche «minière; corporation de mineurs», à travers le serbo-cr. ceh «corporation». Pour cette voie de pénétration de mots allemands en albanais v. mashterk.

**xëgît** «taquiner, agacer». Forme métathétique de gëcit «tenter», une des nombreuses variantes de cys, cyta, «agacer, taquiner; instiguer», nxit «pousser à, inciter».

**xullufe**, cullufe fpl. «toupet de cheveux aux tempes». Du turc zulf, pénétré dans plusieurs langues de l'Europe du Sud-est. En albanais c'est le pluriel, employé au singulier.

**xunkth**, zunkth m. «jonc». Comme l'a remarqué G. Meyer, de l'it. giunco, vén. zunco, et zhukë du serbo-cr. žuka. Mais sung «vitis, cep de vigne» de Blanchus n'est autre que cung «souche d'un arbre, moignon», issu d'un emploi elliptique de cung hardhie «cep de vigne».

**xhagajdúr** m. «chiffonnier, querelleur», non pas d'un gjakhidhuer, gjak «sang» et hedh hidhem «jeter, lancer». Etant donné aussi xhakatúr.

«celui qui rassemble et entretient les joueurs de cartes dans sa maison et les tient en garde de la police», ce mot n'est autre que l'it. *giocatore*.

**xham** f.: v. *gjëmë, gjamë*.

**xhanfës** m. «taffetas». Du turc *canfes*, mot passé dans plusieurs langues balkaniques.

**xhavidhe** f. «coquille, coquillage», mot de l'albanais d'Italie et des parlers toscans méridionaux. Aussi *xhixhivadhe, sharavidhe, shivadhe, hivadhe*, etc. Du néo-gr. *χηβάδα, χημάδα, ἀχηβάδα* «espèce de coquillage, du gr. anc. *χήμη* «came».

**xhevahir** m. «diamant, brillant». Du turc *cevahir*, le pluriel singularisé de *cevher* «pierre précieuse», mot emprunté aussi par les autres langues balkaniques. Du turc *cevherdar* provient *xheverdare* f. «espèce de fusil en silex».

**xheverdare** f.: v. *xhevahír*.

**xhikë** f. «titre donné jadis aux dames musulmanes en Albanie du sud». Forme raccourcie du turc *kadincik* «bonne ménagère».

**xhudhi** m. «juif», dans la mythologie populaire et la toponymie de l'Albanie du nord «géant». Non pas de l'it. *giudeo*, mais de l'anc. it. *giudio*.

**xhulli** f. «espèce de cabane». Le même mot que *xhurdí*, emprunt turc.

**xhurá** f. «flûte de berger». Du turc *zurna* (G. Meyer). Des formes telles que *xurë* confèrent cette étymologie.

**xhurdhék** m. «mariage», chez l'écrivain F. Santori de Calabre. Du turc *gerdek* «chambre nuptiale». Peut-être un mot savant.

**ýjzë** f. «articulation d'une pièce du corps». Ni le proche parent de *yll, hyll* «étoile» (G. Meyer), ni celui du gr. *ὠλένη* «coude» (Barić). Le même mot que *nýjzë* «articulation», du lat. *nodus* (Jokl). Une forme de *sandhi, nýjzë* conçu comme *n yjzë*.

**ylbër** m. «arc-en-ciel». Un composé déterminatif *yll-ber, yll* «étoile», et *ber* «arc», dans *beri i harkut* «courbure de l'arc», *beri i urës* «arche d'un pont». Le *ber* de *ylbër* n'est pas identique à *ber* «serpent» *beronjë* «serpent qui s'enlace à l'homme ou à un animal» (Weigand), ni à *ber*, «flèche, dard» (Phurikis).

**yndyrë, undyrë** f. «graisse déposée par la viande dans le mets». Comme on sait, du lat. *unctūra*. Le maintien de la voyelle initiale démontre pour ce mot un emprunt plutôt tardif, tout aussi bien comme pour *iriq* et *uroj*.

**zagál** m. «taon» aussi *zágal, zegál*, etc. Le même mot que *zekth*, de l'it. *zecca*. Un dérivé à suffixe *-al*.

**zagár** m. «chien de chasse», mot répandu dans plusieurs langues balkaniques. Tenu, depuis Miklosich, comme provenant du turc *zagar*, remontant (selon Triandaphyllidis), à l'arabe *sakar, zagar*, reste en dernière analyse un mot d'origine obscure. Une source slave (*ogar*<sup>1</sup>) n'est point plausible, une source «alarodienne» (*Oštir*) est encore moins probable. Mot préindoeuropéen selon M.L. Wagner, apparenté au sarde *giàgara* «chien de chasse». Opinions semblables chez M. Alessio et M. Hubschmid.

Les rapprochements caucasiques (Korš, Treimer) sont à évaluer d'ensemble avec les réserves de Vasmer. Comme l'a bien relevé N. Jokl, le maintien du -g- intervocalique indique pour l'albanais un emprunt relativement tardif.

**zakûm** m. «oléandre». Mot de provenance turque.

**zall** m. «gravier, galets; lit d'un fleuve, d'un torrent; bord, rivage». Ramené par G. Meyer sans raison valable au lat. *sabulum*, *sablum*, rapproché à tort par Barić à l'irl. *gall* «cruche de pierre, pierre, chaudron», anc. haut all. *kis kisl* «gravier, pierraille», lit. *žiezdrà* «gros sable, gravier», considéré par Oštir un mot «alarodien» et le proche parent du nom de la déesse Ἀθήνη, ce mot a été comparé par La Piana (et déjà par Camarda) au gr. ἀλιγαλός «plage», de même par I. Popović, qui le considère pourtant d'origine «pélasgique», tandis que Skok y voit un mot d'origine slave. Peut-être apparenté au mot celtique *cymbr.* *ialos* «espace découvert, clairière, ial «plaine», ou peut-être au gr. ἰάλιον ἐρέβινθον ἢ τὴν θάλασσαν, indo-eur. *i-*: alb. *z-*.

**zallnisem** «flâner, se balader». Ce n'est le même mot que *dallëndisem* «basculer, branler» (Camarda). Du turc *salinmak*, *salindi* «se balancer, basculer». Même origine que *sallxhák* *sallënxhák* «bascule, balançoire».

**zamare** f. «chalumeau, flûte de berger». Non pas de l'it. *ciaramella* «babillard» (G. Meyer), mais en dernière analyse de l'arabe *zammara* «chalumeau». Le mot apparaît aussi en aroumain et en grec moderne, et d'autre part dans les parlers grecs de Calabre (G. Rohlfs).

**zanë** f. «fée», en Albanie méridionale *zërë* «jeune fille d'une grande beauté. Le reflet de Diana, tout aussi comme le roum. *zîñă* (N. Jokl). *Interpretatio latina* d'une déesse épichore de l'ancienne Péninsule balkanique, dans des inscriptions romaines, découvertes par A. Mayer, Vidaso et Thanae, etc.

**zavrát** m. «plate-bande». Emprunt régional slave, du bulg. *zavratš* «tour», *zavratja* «tourner».

**zbaticë** f.: v. *baticë*.

**zbatóĵ** «appliquer», *zbatím* m. «application». Un lat. \**exbattuo* «battre» comme source (Weigand) est impossible, d'autant plus qu'une telle forme de base n'est nullement attestée en latin, qu'elle est très douteuse même comme source du roum. *mă zbat* «se débattre, se tortiller», comme aussi de l'it. *sbatte* prov. *esbatre* frç. *ébattre*. Peut-être un mot populaire (apparenté à *baticë* *zbaticë*?), mais savant quant à l'acception.

**zbërkóĵ** «déchirer» (dit surtout du loup quand il déchire les brebis), *zbërkohem* «s'étirer». Un verbe dénominal de bark «ventre», forme à réduction de l'a atone à *ë*. Cfr. pour le sens de *zbërkóĵ* le frç. *éventrer*.

**zborák** m. «pinson». Ni du groupe got. *sparwa*, gr. σπέργουλος «passereau» (G. Stier), ni un emprunt du sl., serbo-cr. *čvorak* «esturgeon» (G. Meyer), ni le proche parent du roum. *zbor* «voler» (Pușcariu). Un

dérivé de zborë «neige» (Kristoforidhi), cfr. le frç. pinson de neige, nivereau, l'all. Schneefink, etc. De borë «neige» dérivent entre autres bors, borsëth, borçák.

**zbruj** «ramollir», sens figuré «battre à plate couture», zbruhem «devenir mou, tendre». Apparenté à brumë «pâte, levain»; au point de vue morphologique l'opposé de mbruj «pétrir», mais d'un sens plutôt intensif.

**zđerğjâhem** «s'étendre de ses quatre membres, manquer de respect aux personnes âgées». Un composé zđer-ğjâhem, apparenté à gjanë «large».

**zdirgjem**: v. dergjem.

**zdramë** f. «plaie qui se forme sur le garrot du cheval». Apparenté, à l'intérieur de la langue, à me zdrâ «enfler», zdranem «s'enfler de mangeaille» (Weigand), dans Bashkimi m'u zdrâ me mish «empire il ventre di carne ed altri comestibili in tal modo che questo si gonfi», zdram m. «saleté», dans le dialecte de Mati zdramë dit aussi d'une femme au visage écorché. Peut être apparenté à dregëz «croûte des plaies», et, en dehors de l'albanais, à gr. δέρμα, δора «peau», δρατός δαρτός «écorché», lit. nu-dirtas «écorché», etc. indo-eur. der «écorcher, fendre».

**zëndunë** (me) «prosecare», dans le dictionnaire de Blanchus. Non pas du turc üzendi, de üzenmek «se donner du chagrin» (G. Meyer), mais le même mot que me dhendunë. de dhend, gdhend «tailler du bois, craboter». La spirante interdentale se présente dans ce dictionnaire quelquefois sous la même forme que le sibilant z.

**-zet**, dans njëzët «vingt», dyzët «quarante», en divers parlars aussi trezët «soixante», katërzët «quatre-vingt», etc., non pas du groupe anc. ind. vimçati-h, gr. εἴκοσι, lat. viginti, etc. comme on a opiné jusque-là. Comme «paire, paire de dixaines», plutôt le proche parent de gr. ζυγόν «joug», ζεύγνυμι «atteler, joindre», lat. iugum, got. juk «joug», etc. Forme de base un \*iëuk-t-, correspondant au gr. ζευκτός «attelé, apparié». Assimilation kt: t, comme dans natë «nuît»; lit. naktis, et tetë «huit», gr. ὀκτώ. z initial d'un indo-eur. i- (j);

**zëmër zamër** f. «après-midi; goûter», Blanchus Prandare Me drekunë, ô me zamëruem. Comme le reflet d'une base \*iãmerã ou \*iëmerã, à rattacher au gr. ἡμέρα «jour», armen. aür même sens. Une des concordances partielles de l'albanais avec le grec et l'arménien.

**zgafelle** f. «galérie; tunnel; grotte, caverne»; me zgafullue «traverser». Ni emprunté d'un lat. \*dis-co-affibulare, d'affibulare «agrafer» (Bugge), ni apparenté au lit. žiùpsnis «une poignée», ni non plus au russe gubá «baie, petit golfe» (Treimer), ni un emprunt roman (Jokl). Analysable en z-ga-fell-e, ce mot résulte être le proche parent de gërfëj, zgërfëj «caverne à deux entrées», se rattachant, comme tel, dans son élément thématique, à fell, à fyell «flute», premier sens «creux».

**zgarbë**, zgarbull, zgërbonjë, première forme garbë f. «cavité d'un grand arbre, tronc d'arbre creux», skërbonjë, xgërbunjatë «arbres pourris, morvés. Plutôt que du groupe préroman ligur. garbo «anfratto, antro, grotticella», frç. (Hautes-Alpes) garbo «gros tronc d'arbre creux», etc.,

*c'est un postverbal interne de kalb kalbem «puer, pourrir». Sonorisation de la gatturale comme dans gërbulë «lèpre», qui appartient à ce même groupe lexical.*

**zgargull** m.: v. gargull.

**zgerbe** f. «teigne», chez P. Budi. Le même mot que zgarbë, un pluriel singularisé.

**zgerdhë** f. «bronche». Forme métaphonique d'un zgardh-ï, cfr. i zgërdhaqët «creux», le toponyme Zgërdhësh, aussi le verbe zgardh «ouvrir, détruire une haie», tous dérivés de gardh «haie».

**zgërdhaqët** (i) «creux, dit surtout d'une pierre». Du groupe de zgardh et gardh, v. ci-dessus.

**Zgërdhesh** m., nom d'un village près de Kruja, chez Hahn Skurtësh, dont les ruines ont été attribuées à la ville d'Albanopolis. Un dérivé en -esh de zgardh, ceci de gardh «haie», où rentre entre autres tout aussi Gardhiq Kardhiq.

**zgërdhihem** «se crévasser, se fendre» (des figues); ricaner». Non pas du groupe de ngordh «crever» (G. Meyer), mais une forme verbale à -inj, -ij, de zgardh «ouvrir», détruire une haie». A regrouper ici, entre autres, les synonymes ngërdheshem, ngërdhucem, et en outre gërdhinj «faire rouiller (les plantes); faire gercer la peau», pas bien interprété par G. Meyer, p. 123.

**zglëng** m. «trait, gorgée», mot de l'albanais de Grèce. Non pas du bulg. glbtk (G. Meyer), mot qui survit d'ailleurs dans gëlltit «engloutir, avaler», mais une formation onomatopéique, tout comme les variantes gllënkë et zgllënkë des parlars d'Albanie, cfr. l'expression e piu gllënk «il le but à un trait». Ici rentrent encore les synonymes zguith e zgunj.

**zgobinalle**, **zgobinetë** f.: v. gomën.

**zgrip** m. «corne, bord, bordure», i zgripët «économe, ménager», du groupe de krep, shkrep «roc, écueil» (G. Meyer, N. Jokl). Le rapport e : i existant dans le vocalisme de ces formes, plutôt que dérivant d'une évolution r : ri (M. Camaj), évolution de date préhistorique, est postérieur et interne, dérivant, dans zgrip, peut-être du pluriel.

**zgrof** m. «estomac de l'homme, estomac du bétail». Pour des raisons d'ordre phonétique, non pas — avec le roum. scorbura «antre, caverne» — du lat. scrobis, scrobs «fosse, trou» (Jokl). Etant donné zgrop même sens, les verbes zgropem et m'u zgërrop barku së pangrani = je sens le vide de l'estomac, j'ai des tiraillements d'estomac par suite du jeûne, j'ai grand-faim», l'appartenance à zgropoj «creuser» et en dernière analyse à gropë «fosse, fossette» est évidente. Ici rentre encore zgrovót m. «monstre; vampire, revenant», une forme à suffixe — ot.

**zguith** m.: v. zglëng.

**zgunj** m.: v. zglëng.

**zgurdulló**j «ouvrir les yeux de toute leur largeur». En vertu de zgardhullónj «spalancare, stralunare, sgranare, aprire» et de la derën

zgardhull «*ha lasciato la porta spalancata*» de l'albanais de Calabre (Giordano), ce mot résulte être du groupe zgardh, zgardhë, Zgërdhësh et zgërdhihem, ci-dessus examinés, et appartenir en dernière analyse à gardh «haie».

**zgurdhë** f. «rectum». Rattaché par N. Jokl à zorrë «intestin; entrailles, boyaux», angërr «péritoine; plèvre» et ngranë ngrënë «mangé», et, en dehors de la langue, au lat. vorare «avalier, engloutir», anc. ind. girāti «engloutir», etc., ce mot est apparenté en première ligne à zguer zgori m. «trou, endroit creux; diaphragme; creux de l'estomac», zgorkë f. «fosse dans le lit d'un fleuve, petit trou; ventre», zgorç «creux», etc. Sens premier plutôt «creux, creusé» que «engloutir».

**zgjedhë** f. «joug», zgjedhó «atteler au joug, zgjedhim m. «conjugaison». Ni un emprunt du néo-gr. ζεύγλα, ζεύλα (G. Meyer), ni le proche parent du lat. ligo, -are et du lit. laigōnas «frère de la femme», puisqu'un \*zgedhë supposé à ce propos n'existe pas. Si c'est le reflet d'un \*zgdhë, on peut rapprocher le mot germanique vieux fris. gadia «réunir», all. Gatte «époux», cfr. pour le sens lat. coniux : iugum. A zgjedhë appartient zgjedharë-t mpl. «orion» (cfr. le lat. iugulae), et probablement aussi ngjedh «ceindre», aoriste ngodha, chez G. Dara de Sicile Atë thikëz të ngodha! «Quel pagnaletto ti cinsi!».

**zgjic** m. «petite baie, petite embouchure». A analyser en z-gji-ç, gjí «sein».

**zgjollë, zxhollë** f.v. gëzhojë.

**zgjua** zgjue m. «ruche». Ni d'un lat. \*excavone, de cavus «creux» (Weigand), ni d'un lat. excovo «creux», réfleté par le port. covo «creux», esp. cueva «caverne» (Jokl), bases toutes les deux reconstruites. Telles formes comme zgüe (Bogdani), zgue, zgoi, pl. zgoja, feraient supposer une forme de base à gl-, \*glon-.

**zî** f. «disette, famine», mezí «à peine», i zî «noir», fem. e zezë. Plutôt que le correspondant de lit. žilas «aux cheveux gris», let. zils «bleu» (G. Meyer), ou bien du lit. gedù «être en deuil», gëda «deshonneur, honte», rus. gadkij «sale, dégoûtant», all. Kot «merde», etc. (Jokl), ce mot est apparenté au lit. jùodas «noir», let. juods «esprit des bois, esprit malin»; alb. z-d'un j-(i-), zî et l'adjectif i zî d'un \*jōdiā, jōdiā, le pl. masc. të zez d'un \*jōdii (\*jōdii). Le nom personnel illyrien Jadia peut rentrer, en tel que «Bruna», dans ce même groupe de mots.

**ziej** «bouillir, cuire, fermenter». L'idée d'une origine grecque, néo-gr. ζέω «bouillir» (G. Meyer), se heurte au fait que ζέω ζέσα aurait donné un \*zes. Mot des sources indigènes, du groupe anc. ind. yásati «bouillir», gr. ζέω, anc. h. all. jesan «fermenter», etc. (Camarda, St. Mann). Forme de base \*iesniō, plutôt que (avec Mann) \*ieseiō. Hittite zeja «bouillir» peut rentrer dans ce même groupe, aussi que (avec A. Mayer) le nom des termes Aquas Jasas dans l'actuelle Croatie.

**zis** zit «exciter, provoquer». Non pas du serbo-cr. zatka «provocation», de zataći «mettre, pendre», comme opinait G. Meyer. Du groupe cys cyta «agacer, taquiner», nxis, nxit «pousser à, inciter», nxitó «se

*hâter*», gëcît «*tenter*», etc. Une parenté de *zit* et *nxit* avec *lat. vita*, *lit. gyvatà* «*vie, habitation*», etc. (St. Mann), pour des raisons de sens et d'autres nous semble insoutenable.

**zmojë** f. «*terrain inculte, jacère*». Selon Jokl, d'un *lat. vulgaire* \**exmulgia*, postverbal de *e(x)mulgeo* «*traire jusqu'au bout, tarir*». L'ouverture de *l'u* en *o* ne remonte pas au latin de la *Praevalitana*, mais provient plutôt d'une évolution interne, au fond aux parlars albanais du nord-est.

**zog** m. «*oiseau; petit des oiseaux; petit des animaux*». Rapproché par G. Meyer de l'*arm. jag* «*jeune oiseau, petit oiseau*», *pers. moderne zâq* «*petit d'un animal*», *anc. ind. jahu* «*petit d'un animal*», forme de base \**g'hāgos*, ce mot, dont le sens premier est «*jeune*», se rattache au *gr. ἦβη* «*force juvénile, âge de la force, jeunesse*», *ἔφηβος* «*adolescent*», qu'on unit au *lit. jegà, pajegà* «*force, entendement*», *let. jėga* («*force physique, intelligence*»). Forme base de *zog* \**jėgwo-* (\**ieogwo-*). Les mots de l'arménien et du persan peuvent appartenir à ce même groupe.

**zogorì** f. «*troupeau de loups, de sangliers, de chiens; bande*» Un dérivé de *zog*, premier sens «*troupeau d'oiseaux*».

**zurmë** f. «*renommée, gloire*». Ni indentique à *zurnë*, cule «*chalu-meau, flûte de berger*», du *turc zurna* (G. Meyer), ni d'un *zâ lum* «*bonne renommée* (A. Xhuvani), ni apparenté au *gr. ἕλκος* «*chant en honneur de la déesse Démètre*» (St. Mann). Mot d'existence douteuse, se trouvant chez les écrivains de Calabre, non pas dans le langage populaire.

**zvugullón:** v. *vagëllój*.

**zxhollë** f.: v. *gëzhøjë*.

**zymtë** (i) «*sombre*», *zymtój* «*assombrir*», dans *Blanchus zýmënë* «*maestus*», *me u zymënyem* «*maerere*», *zymënim* «*tristitia*». Un dérivé de *i zi* «*noir*». Suffixe double, -*m-të*, dont le premier marque la ressemblance.

**zhagít**, *shagít* «*traîner*». Aucun rapport avec *shes* «*vendre*» et *shëlligë* «*vipère; le petit du dragon*», comme pensait H. Barić. Du groupe de *zharg* «*en traînant*», *zharg* «*dépouille du serpent en printemps; peau qui enveloppe la caisse du luth; écorce de l'arbre*», *zhargój* «*traîner*». Appartient en dernière analyse à *shark* «*enveloppe verte des noix; pulpe des fruits à noyau, des drupes, tels que la pêche et la prune*», *sharku i bollës* «*dépouille du serpent*», *shakull* «*oultre*», *rrëshék* «*oultre; soufflet (de forgeron)*», etc., v. *shark I. et II.* *zh-* initial d'un *sh-*, comme dans beaucoup de cas.

**zhangë**, *zhangël*, f. «*restes de viande frite*». Du groupe de *zhag*, *shag*, ci-dessus examiné.

**zharg** m. «*dépouille du serpent en printemps; peau qui enveloppe la caisse du luth; écorce de l'arbre*», v. *zhag*. De ce même groupe est *zherku* «*peau d'animal qui sert de caisse de résonance du luth*».

**zhdo** «quelques» (Buzuku), dans le parler de Borgo Erizzo (Dalmatie) dizhdó. Correspond à çëdō «quelques» de l'albanais de Sicile, à çdo «chacun», base commune ç'do «qu'est-ce-que tu veux». Ici rentrent encore çokú «quelque part» et çoç «quelque chose», pas bien interprétés par H. Pedersen.

**zhdrivilló;** «développer». Une origine slave, serbo-cr. ždrijeb-«sort», ždrebati «tirer au sort» (G. Meyer, Selišćev, Skok) est impossible. Rapproché par Jokl à i zhdërvjellët «leste, svelte» et rattaché comme tel à la base indo-eur. \*vel- «tourner, rouler, tordre», lat. volvo «rouler, faire rouler; rouler dans son esprit», etc. Etymologie répétée par Barić, sans en nommer l'auteur.

**zherk** m.: v. zharg.

**zhyej, zhyj** «souiller, salir». Une forme de zhys.

**zhys** «plonger» zhytem «je me plonge». Ni du groupe de gr. βάπτω «plonger» (Barić), ni apparenté, au dedans de la langue, à ujë «eau» (M.E. Schmidt). zhytër f. «Colymbus ruficollis; Podiceps auritus, zhyt-kryekuqe «Podiceps auritus», etc. La véritable forme est shys, shytem, attestée par P. Bogdani et subsistant encore dans le parler de Peja (Ipek), cfr. aussi shytër «piccola folaga» de Junk. Le même mot que shyt, dans l'expression ra shyt përdhë «il est tombé comme un sac» et identique à shyt, shut «sans cornes». Evolution sh-: zh-, comme souvent.